



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3467 · e hënë, 24 shtator 2018

13°C | 28°C

15 DEN

EDITORIAL

**Kur Enver
Hoxha
shqiptarët e
Maqedonisë
i quante
"pakicë"**



Hapja e shkollave të para kombëtare shqiptare, në historiografinë më të re shqiptare konsiderohet si Rilindja e dytë për shqiptarët e këtyre trojeve. S'do mend se për këtë meritë të madhe patën mësuesit shqiptarë, të cilët me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, përkatësisht ministrit Koliqi, që të kyçen në procesin e hapjes së shkollave në viset e lira, me kënaqësi pranuan të vijin në këto vise, duke i lënë të gjitha privilegjet që i gëzonin atje, vetëm e vetëm që t'ju dalin në ndihmë vëllezërve të tyre...

Fq.18

RAJON

**Përplasja
që po dëmton
Kosovën**

Fq.16

GLOBI

**"Fort Trump"
në Poloni!**

Fq.17



EVROPA PAGUAN 1.89, MAQEDONIA 6.2 PËR QIND

KAMATAT TRE HERË MË TË SHITRENJTA SE NË BE



Lartësia e kamatave për amvisëritë apo personat fizik, vitin e kaluar në Maqedoni në mesatare ka qenë 6.2 për qind, ndërsa kamata mesatare në Eurozonë për amvisëritë dhe firmat ishte 1.89 për qind. Arsyeja se pse kështu qëndrojnë numrat, sipas ekspertëve, është se Maqedonia dhe shtetet e rajonit më shumë importojnë se sa eksportojnë, apo me fjalë tjera - pak "prodhojnë para" në industri dhe shërbime

Fq.4

Buka varet nga importi

Shkup, 23 shtator - Maqedonia vite me radhë nuk arrin ta sigurojë bukën për nevojat e saja vetëm nga prodhimtaria vendore e grurit. Në nivel vjetor shteti ka nevojë për afër 339 mijë tonë grurë, prej të cilave, 280 mijë tonë nevojiten për prodhimin e bukës dhe parodive të bardha, afër 32 mijë tonë nevojiten për materiale të mbjelljes dhe afër 18 mijë tonë shkojnë për rezervat shtetërore. Maqedonia në vitet e kalua-

ra përmbushte nevojat e saja për grurë në mesatare prej 60 për qind, ndërsa pjesa e mbetur importohet nga jashtë. Thënë ndryshe, nga prodhimtaria vendore sigurohen afër 200 mijë tonë grurë, ndërsa nevojat prej afër 100 mijë tonë të grurit dhe miellit plotësohen me importin nga Serbia, Bullgaria, Kroacia etj.

Problem tjetër i prodhimtarisë vendore të grurit është edhe rendimenti...

Fq.7



EDITORIAL

GJERMANI THIRRI ARSYES!



Jens THURAU

Ta themi qysh në krye të herës: populistët e djathtë të "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) nuk ofrojnë asgjë, asgjë fare për zgjidhjen e problemeve në vend. Tema e vetme e tyre është, se refugjatët janë shkaku i të gjitha problemeve. Ata bëjnë sehir kur në demonstratat e tyre bëhen përshëndetje hitleriane, ata heshtin, kur sulmohen restorante hebreje. Tema të tjera - mungesa e bane-save, çështjet sociale - atyre nuk u interesojnë.

Por ata kryesojnë në sondazhin e fundit të ARD-së për herë të parë kundrejt socialdemokratëve (SPD), partisë prestigjioze, partisë më të vjetër gjermane. E ky është vetëm fiksimi i një çasti në një zhvillim, që ende nuk ka marrë fund. Në landet lindore të Gjermanisë AfD-ja sipas anketimeve arrin mesatarisht vendin e parë. E megjithatë: 82 për qind e të pyeturve në sondazh nuk kanë vendosur për AfD. Po të hedhësh një sy në vendet e tjera europiane kupton, që Gjermania megjithatë rezulton mjaft mirë. Në Itali populistët janë në pushtet, Hungaria dhe Polonia qeverisen prej populistëve. Ndërsa në Uashington gjëmon Donald Trumpi. 18 për qind e të pyeturve pra do të votonin për AfD-në. Një parti antidemokratike, ksenofobe, plot reminishenca, pa empati për minoritetet. Një parti, e cila vë në pikëpyetje ndarjen e pushteteve. A janë këta 18 për qind të gjithë edhe të këtij mendimi?

Në fakt jo. Nëse në Chemnitz, ashtu sikurse ndodhi, mijëra qytetarë i bashkohen një marshimi në demonstratë, në krye të së cilës himnizohet Adolf Hitleri dhe bëhet thirrje për të sulmuar shtetin, atëherë kjo më keq s'ka ku të vejë. Por kjo është edhe shenjë, që njerëzit nuk gjejnë një vend tjetër, në të cilin të munden të shkarkojnë indinjatën dhe zhgënjimin e tyre. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për azilkërkues dhe probleme bashkëjetese, por ndër të tjera edhe për këtë. Këtu është fjala për vlerësim, respekt, ndjenjës, se nuk të marrin seriozisht, kur në një botë të pasigurt po shtohen gjithnjë e më shumë frikërat.

Prej shumë kohësh të gjitha partitë i kanë lënë pas dore temat thelbësore si mungesa e bane-save, pabarazia sociale. Nga një atmosferë e tillë gjithmonë historia ka treguar, se pavarësisht ku, përfitojnë ata që i thjeshtojnë më së shumti gjërat dhe nxisin urrejten. Por në Gjermaninë e pasluftës, fillimisht vetëm në Perëndim, ka qenë ndryshe. Nisur nga përvoja prej krimeve të tmerrshme të nazistëve, shumica e gjermanëve mendonin për pajtim, maturi dhe sa më pak debate polarizuese. Tani gjërat kanë ndryshuar. Anë e mbanë ndihet acarimi, në rrugë e nëpër qytete. Politika e vjetër, e etabluar luan rolin e vet këtu: e pëshëlluar në grindje të hapura, për muaj të tërë, pa impulse të vërteta për zgjidhje lidhur me politikën e azilit. Hesht gjithashtu, që prej kohësh në qeveri ka një konsensus, që në thelb duhen mbyllur kufijtë e Europës. Kushdo e kupton, se këtu kemi të bëjmë edhe me larje personale hesapësh, si p.sh. mes kancelares dhe kritikëve në radhët e saj, kryesisht në radhët e kristiansocialëve, partisë bavareze simotër e kristiandemokratëve të kancelares. Ndërsa në mediet nuk ia dalim, që një pjesë të popullsisë, e cila voton për AfD-në pa qenë vërtetë ekstremiste e djathtë, ta vlerësojmë poizitivisht dhe ta pasqyrojmë atë vërtetë ashtu siç është me motivet e saj.

Tani është e nevojshme, që shoqëria duhet ta mësojë nga e para bashkëbisedimin. Njerëzit e arsyeshëm në të gjitha partitë e etabluara - të tillë ka - duhet t'i çojnë ato në parada e t'u japin mikrofonin për të mbrojtur demokracinë. Ndërsa mediat duhet të kujtojnë një parim të vjetër e të mirë të tyre: të raportojnë. Jo duke u bërë palë vetëm me një anë - e jo vetëm me një anë të mirë. (DW)

ÇFARË AMERIKE NA DUHET NEVE

"Neve na duhet miqësia me Amerikën, por mbi të gjitha na duhet aleanca me botën demokratike. Kosova nuk e ka fituar lirinë pse Amerika kishte miqësi të veçantë me shqiptarët, por pse në Kosovë janë shkelë brutalisht të drejtat e njeriut, është derdhur gjaku i njerëzve të pafajshëm dhe është bërë gjenocid. Neve nuk na duhen liderë që tregojnë vullnet për t'u bërë marioneta të një administrate të caktuar, por liderë që dinë ta udhëheqin vendin drejt botës perëndimore që sublimon vlerat më të larta demokratike e civilizuese.

Duke punuar kështu, ne do të jemi në aleancë permanente me çfarëdo administrate dhe qeverie demokratike dhe nuk do të rrezikojmë humbjen e mbështetjes politike, ekonomike dhe ushtarake të vendeve të caktuara pavarësisht ndërrimit e pushteteve. Deklarata e Presidentit Thaçi për vendosjen e ambasadës sonë në Jerusalem në rast se na një Izraeli, nuk është në frymën më të mirë të miqësisë dhe bashkëpunimit tonë me botën demokratike dhe më shumë e dëmton sesa e ndihmon diplomacinë tonë të brishtë dhe imazhin e shtetit të ri që pret t'i bashkohet Evropës.

Ajo që ka thënë Angela Merkel se 'ka ardhur koha që fatin tonë duhet ta marrim në duart tona' (fjala është për Evropën e bashkuar) vlen edhe për neve. Fati ynë nuk guxon të varet apo të përcaktohet nga konfliktet e mikut tonë të madh, SHBA-së me miqtë tanë tjerë që i kemi në Evropë dhe gjithandej botës, por nga puna jonë dhe harmonizimi i të drejtës sonë me të drejtën ndërkombëtare", shkruan në profilin e tij në Facebook, shkrimtari nga Kosova, Liri Loshi.

GARA MES HISTORISË DHE BUXHETIT

"Meqë në përvojën e deritanishme nuk ndodh që numri i veteranëve (me gjithë ligjet e biologjisë) të zvogëlohet, por mundet vetëm të rritet me faktorë të mundshëm dhjetëfishimi, atëherë gara mes historisë dhe buxhetit të Kosovës duhet të humbet nga buxheti i Kosovës. Kështu më duket se është logjika e kësaj dhe qeverive të udhëhequra nga PDK-ja, që buxhetin e shohin si një thes të madh të parave nga i cili nxirret gjithnjë, si të ishte i pashtershëm. Kur duhet mbushur, dikush prej komandantëve në krye të Qeverisë i adresohet ndonjërit prej ministrave që ta gjejë çarenë dhe thesi mbushet sërish, duke përdorur një mekanizëm që nuk vërehet në popullatë-vendi hyn në borxh të brendshëm. Kështu shteti i Kosovës ka arritur që heshtazi të kalojë prej zeros në një miliard euro borxh. Por gara mes historisë dhe buxhetit nuk mund të ndalet me kaq. Siç qe vendosur më herët, buxheti i Kosovës u ndan pensione shtesë arsimtarëve që punuan në vitet 1990-1999, pra ka njohur meritën e tyre historike, tej faktit se atëbotë janë paguar për punën e bërë, kategoria e vetme e shqiptarëve që ka marrë në formë konsistente rrogë në Kosovë. Rrjedhimisht, së bashku me veteranët e UÇK-së dhe arsimtarët e viteve nëntëdhjetë, ndoshta do të ishte mirë që historia nuk mund të injorojë kategori të tjera të kontribuuesve për çlirimin e Kosovës, për shembull anëtarët e LDK-së (Alternativës) dhe pjesëmarrësit në demonstrata paqësore...", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti nga Prishtina, Veton Surroi.

MEDIACitate

NUK DUHET VËNË AFAT PËR BISEDAT KOSOVË-SERBI

Nuk do të ishte mençuri që të afatizohen negociatat ndërmjet Serbisë e Kosovës, të paktën jo derisa të arrihet diçka e prekshme se kjo çështje mund të përfundojë, ka thënë për FoNet ambasadori i SHBA-së në Serbi Kyle Scott. Ai ka theksuar se marrë para sysh dinamikën globale në vitin e ardhshëm, ky është rast fantastik që të bëhet përparim dhe që nuk duhet lënë. Sipas tij, ka mundësi që në vitin e ardhshëm të ketë zgjedhje në Kosovë e në Serbi dhe ka tërhequr vërejtjen se "situata në këtë rajon është gjithmonë e komplikuar". Me përkujtimin se „dialogu i Serbisë dhe i Kosovës nga faza teknike, ka kaluar në fazë më të komplikuar në të cilën flitet për marrëveshjen gjithëpërfshirëse", Scott ka thënë "se vetë kjo flet për përparimin", ndaj, ka konstatuar ai, nuk pajtohet me vlerësimin se bisedat kanë ngecur. Sipas fjalëve të tij, SHBA-ja nuk është drejtpërdrejtë e përfshirë në negociatat që zhvillohen ndërmjet Serbisë e Kosovës me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe se është shumë e rëndësishme që ato të orientohen në marrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe të zgjidhja. "Ka ide, disa janë të suksesshme, disa jo, e sipas mendimit tonë, është me rëndësi t'iu jepet rasti dhe hapësira liderëve të Serbisë e të Kosovës që të bisedojnë, të jenë fleksibël e kreativë dhe të arrijnë te zgjidhja e përhershme që do të mund të zbatohet dhe që ajo të jetë e pranueshme për qytetarët e dy vendeve", ka theksuar Scott. Sipas fjalëve të Scottit, "kemi liderë që po lëvizin drejt zgjidhjes, marrëveshjes që është e mirë për popujt e tyre". "Nuk ka vend në rajon të jetë i dënur me konfliktin e ngulitur", ka thënë Scott duke marrë shembullin e Maqedonisë e të Greqisë që ai dolën ta zgjidhin konfliktin disa deceniesh rreth emrit. "Mendoj se mund të presim që kjo të ndodhë edhe me Kosovën e Serbinë", parasheh Scott dhe shton se konflikti i ngrirë prodhon destabilitet. I pyetur pse SHBA-ja përnjëherë vendosi ta përkrahë idenë për "për korrigjimin e kufijve", ai ka thënë se SHBA-ja nuk ka vendosur për këtë ose për atë, porse ka vendosur që të dy palëve t'iu japë hapësirë që të merren vesh.

(FoNet, 23 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

SI ËSHTË QUAJTUR MË PARË MYZEQEJA?

Myzeqeja është qendër e një qytetërimi të lashtë (Apolonia e dëshmon). Në territorin e saj banonte fisi ilir i Taulantëve. Emri i saj i vjetër ishte fusha e Savrës, në periudhën e mesjetës këtu u ngrit principata feudale e Muzakajve, prej të cilëve mori emrin e ri. Pas pushtimit osman një pjesë e popullsisë mërgoi ose u shpërngul në vise të thella. Pas shekullit XVII filloi rikthimi i saj.

Përveç popullsisë vendëse, që quheshin lalë, janë vendosur edhe labë (në Myzeqenë e Fierit), gegë nga Kërraba, Mati, Çermenika, Dibra (në Myzeqenë e Lushnjës) dhe kosovarë e çamë të ardhur në shekullin e kaluar. Në organizimin shoqëror mori trajtë një kanun, që përfshinte norma nga kanunet tradicionale, nga e drejta kanonike dhe nga sheriat.

Në delegacionin, i cili do të numërojë rreth dyzetë persona nga shumë institucione, do të jetë edhe ministrja e Drejtësisë Renata Deskoska. Skringingu në të gjitha kapitujt duhet të rrumbullaksohet deri në qershor të vitit 2019

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 23 shtator - Më 27 shtator fillon periudha përgatitore për procesin e inkuadrimin të Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Zëvendëskryeministri dhe njëherësh edhe shef i delegacionit të Maqedonisë për negociata me BE-në, Bujar Osmani në konferencën për shtyp dje njoftoi se do ta kryesojë delegacionin e Maqedonisë në Bruksel, i cili më 27 shtator do ta fillojë skringun për kapitullin 23 - gjyqësori dhe të drejtat fundamentale. Në delegacionin, i cili do të numërojë rreth dyzetë persona nga shumë institucione, do të jetë edhe ministrja e Drejtësisë Renata Deskoska. Skringingu në të gjitha kapitujt duhet të rrumbullaksohet deri në qershor të vitit 2019.

Qeveria shpalli thirrje publike për paraqitjen e ekspertëve të jashtëm për procesin e negociatave. Qëllimi është që të bëhet baza e ekspertëve nga të gjitha sferat, tha Bojan Mariçiq, negociues i përgjithshëm teknik dhe shef i ekipit negociues, i cili theksoi se kjo nuk do të thotë përjashtim i shoqërisë civile nga procesi i negociatave.

Ndërkohë, një javë para mbajtjes së referendumit për ndërrimin e emrit të Maqedonisë dhe anëtarësimit në NATO, policia

MAQEDONIA I FILLON NEGOCIATAT ME BE-në

SKRNINGU NIS ME GJYQËSORIN



e shtetit ka njoftuar se është në gatishmëri të plotë për krijimin e ambientit demokratik. Kështu është shprehur të dielën ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, i cili ka theksuar se çdo tentim për pengimin e të drejtës së votës, do të sanksionohet. "Maqedonia është shtet i lirë demokratik me tipare evropiane. Çdo lloj presioni, kërcënim apo shantazh gjatë procesit votues, do të pengohet dhe

dënohet në pajtim me kornizën ligjore. Kjo vlen edhe për aktivitet në internet", tha Spasovski. E drejta e votës, siç potencoi ai, është e drejtë e padiskutueshme dhe se sekretin e votës është i garantuar.

"Institucionet do të garantojnë realizim të suksesshëm të referendumit të 30 dhjetorit, gjegjësisht qytetarëve do t'ju mundësohet të votojnë në bazë të bindjeve dhe vullnetit të tyre. Vota e qytetarëve

vendos për të ardhmen e Maqedonisë. Policia është në krye të detyrës që t'ju mundësoj qytetarëve shprehje të lirë të vullnetit të qytetarëve", theksoi Spasovski. Referendumi në bazë të të cilit qytetarët duhet të vendosin se janë "PËR" apo "KUNDËR" pranimit të marrëveshjes mes Greqisë dhe Maqedonisë, si dhe për NATO dhe BE, pritet të mbahet vikendin e ardhshëm.

Ju presim në NATO

Shkup, 23 shtator - Tani është koha që të dëgjohet zëri juaj. Kjo është një mundësi që jepet njëherë në jetë. Dera e NATO-s është e hapur. Por, vetëm qytetarët e vendit tuaj mund të vendosim për ta kaluar. Prandaj, ardhmëria juaj është në duart tuaja. Ju presim në NATO, porositi sot sekretari i përgjith-

shëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Sërish treguat guxim, thotë në video fjalimin Stoltenberg, për ta kaluar rrugën tuaj personale drejt pavarësisë, paqes dhe sigurisë. Marrëveshja historike për kontestin me emrin e hap mundësinë për anëtarësim të barabartë në bashkësinë ndërkombëtare, duke

e përfshirë anëtarësimin e barabartë në NATO. "Anëtarësimi në NATO do t'ju japë shans juve dhe fëmijëve tuaj siguri që vjen kur jeni pjesë e aleancës më të suksesshme në botë dhe do t'ju japë vendit tuaj votë të barabartë në diskutimet tuaja dhe deklarim të barabartë në vendimet tuaja",



deklaroi sekretari i përgjithshëm i NATO s, Jens Stoltenberg.

SOLANA ME KOLUMNË I DREJTOHET MAQEDONISË

Marrëveshja e Prespës, shpresë për konfliktet e tjera në rajon

Bruksel, 23 shtator - Në një kolumnë të botuar nga "Proxhekt Sindikejt" ish-shefi i Politikës së Jashtme të BE Javier Solana trajton referendumin e ardhshëm mbi mosmarrëveshjen e emrit dhe rëndësinë e kësaj marrëveshje për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tjera dypalëshe. Marrëveshja e Prespës, shkruan Solana, "ofron një model të qëndrueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet edhe diku tjetër,

sepse ajo përmban një qasje gjithëpërfshirëse për të zgjidhur konfliktet në bazë të një premtimi të përfitimeve të përbashkëta afatgjata", duke dhënë shembullin e nenit 15 të traktatit me Greqinë i cili i referohet bashkëpunimit në fushën e arsimit, kulturës, teknologjisë etj. "Kjo marrëveshje e palëve me një mosmarrëveshje të gjatë është një frymëzim për një rajon që mbetet i ngatërruar në

mosmarrëveshjet e bllokuara mbi identitetet etnike dhe kombëtare. Ballkani - dhe jo vetëm Ballkani - ka nevojë për një narrativ të ri të bazuar në prioritetet e vërteta të popullit, pikërisht atë që parashikon Marrëveshja e Prespës", tha ish-kreu i diplomacisë evropiane. Si shembuj Solana i përmendi mosmarrëveshjet midis Kosovës dhe Serbisë, si dhe tensionet politike në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në

Republikën Serpska. Por, sipas Javier Solanës, nëse "java përfundon siç duhet", domethënë nëse marrëveshja pranohet nga qytetarët në Maqedoni, kjo do të rimarrë shpresën për rajonin. Për Solanën, Marrëveshja e Prespës, nëse kalon, do të nënkuptojë gjithashtu kundërshtimin e "kthesës globale ndaj shovinizmit". Javier Solana e përshëndet udhëheqjen dhe guximin e dy kryeministrave, Zoran



Ivanovi bojkoton

Shkup, 23 shtator - Dy herë e kisha besimin e qytetarëve për të mos lejuar ndryshim të Kushtetues me qëllim të ndryshimit të emrit kushtetues, të mos pranoj ide dhe propozime që do t'i rrezikonin identitetin kombëtar të Maqedonisë, veçantitë e kombit të Maqedonisë, gjuhën maqedonase dhe modelin e bashkëjetesës në Maqedoni. Nuk heq dorë nga ai premtim i im. Prandaj, më 30 shtator nuk do të dal për të votuar, ka thënë kështu presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov para Diasporës së Bashkuar të Maqedonisë në Detriot, kumtoi Kabineti i Presidentit. Presidenti Ivanov theksoi se në pajtim me nenin 7, paragrafi 3 nga Ligji për referendum, askush nuk mund të thirret në përgjegjësi për votim, gjegjësisht mosvotim në referendum. Secili qytetar, ka thënë Ivanov, ka të drejtë të vendos si të veprojë lidhur me këtë referendum, të dalë dhe të votojë, ose të mos dalë dhe të bojkotojë. "Sa më përket mua, unë tani më kam votuar. Votova para 27 viteve, në 8 shtator të vitit 1991. Unë isha njëri prej atyre të cilët e dhanë votën e tyre për Republikën e Maqedonisë që të konstituohet si shtet sovran dhe i pavarur, me emër dhe dinjitet. Nuk heq dorë nga vendimi im. Prandaj më 30 shtator nuk do të dal për të votuar. Kur e mora funksionin President i Republikës së Maqedonisë, jam betuar se do t'i respektoj Kushtetutën dhe ligjet. Nuk heq dorë nga betimi im. Prandaj, më 30 shtator nuk do të dal për të votuar", potencoi presidenti i Maqedonisë. Ivanov porositi se në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve. "Mos lejoni ndokush t'ua marrë atë të drejtë, mos lejoni ndokush tjetër t'ua kontrollojë ndërgjegjen tuaj dhe krenarinë tuaj kombëtare", theksoi presidenti i Maqedonisë.



Zaev dhe Aleksis Cipras dhe kujton se ata të dy përballen me sulmet e forta nga opozita vendase.

Lartësia e kamatave për amvisëritë apo personat fizik, vitin e kaluar në Maqedoni në mesatare ka qenë 6.2 për qind, ndërsa kamata mesatare në Eurozonë për amvisëritë dhe firmat ishte 1.89 për qind. Arsyeja se pse kështu qëndrojnë numrat, sipas ekspertëve, është se Maqedonia dhe shtetet e rajonit më shumë importojnë se sa eksportojnë, apo me fjalë tjera - pak "prodhojnë para" në industri dhe shërbime

EVROPA PAGUAN 1.89, MAQEDONIA 6.2 PËR QIND

KAMATAT TRE HERË MË TË SHITRENJTA SE NË BE



Letoni me 5.55 për qind. Njëherazi, Sllovenia dallohet me kamata mesatare prej 2.84 për qind.

"Niveli i kamatave varet nga më shumë tregues që pasqyrojnë gjendjen vendore ekonomike dhe trendet e zhvillimit ekonomik në çdo shtet në veçanti. Në këtë drejtim, një nga faktorët kryesor që dikton lartësinë e kamatave është edhe faktori i rrezikut në shtetet ku punojnë dhe jetojnë bankat dhe konsumatorët e kredive. Ndikojnë edhe harxhimet e ndryshme të bankës siç janë mbulimi i kredive me rrezik të kthimit, pagat e punëtorëve, marzha apo fitimi i saj etj", thonë njohësit e tregjeve financiare.

Ndryshe, analizat e kostos së kamatave në shtetet e BE-së dhe shtetet e rajonit tregojnë se banorët e Ballkanit paguajnë për disa herë kamata më të shtrenjta se banorët e shteteve evropiane. Përdorimi i valutës së përbashkët - euro, ndikon në stabilitetin e sektorit financiar dhe nivelin e ulët të normave të interesit në Eurozonë. Gjithashtu, shtetet jashtë zonës së euros akoma i nënshtrohen kostos së rrezikut kreditor. Shkallët e kamatave në shtetet evropiane që përdorin euro janë të ulëta edhe si rrjedhojë e ambientit të fuqishëm dhe efikas institucional që imponon eurozona.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 shtator - Qytetarët e Maqedonisë i paguajnë kamatat tre herë më shtrenjtë se qytetarët e Bashkimit Evropian. Lartësia e kamatës për amvisëritë apo personat fizik, vitin e kaluar në Maqedoni në mesatare ishte 6.2 për qind, ndërsa kamata mesatare në anëtarët e Eurozonës për amvisëritë dhe firmat ishte 1.89 për qind.

Bankierët thonë se vitet e kaluara, në Maqedoni shënohet një ulje e kamatave për kreditë e qytetarëve, edhe pse shtojnë se kjo nuk ndodh me atë ritëm që dëshirojnë qytetarët. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat e Bankës Popullore, sipas të cilave, kamatat mesatare për qytetarët në dhjetor të vitit 2015 kanë qenë 6.8 për qind, për t'u zvogëluar në 6.2 për qind në muajin korrik të këtij viti, si rrjedhojë edhe të liberalizimit të politikës së Bankës Popullore në drejtim të rritjes së kreditimit përmes uljes së kamatave të kredive, por edhe trendeve pozitive në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Ekonomistët vlerësojnë se shkallët e kamatave varen prej

ofertës dhe kërkesës së të hollave në tregun financiar, investimeve më të madhe private apo shtetërore, si dhe situatës stabile politike në një shtet. Gjithashtu, shtetet e rajonit nuk prodhojnë "para", apo kanë nivel shumë të ulët të prodhimeve dhe shërbimeve që shiten jashtë, kanë minus në këmbimin tregtar andaj edhe nuk mund të ulin më shumë kamatat.

"Një nga faktorët kryesor jo vetëm në Maqedoni, por edhe shtetet e rajonit e që ndikon në kamatat më të larta në Ballkan në raport me

shtetet evropiane, është fakti se ato më shumë importojnë se sa eksportojnë, apo me fjalë tjera - pak "prodhojnë para" në industri dhe shërbime", thonë ekonomistët.

Sipas tyre, çdo kund në botë lartësia e kamatave të kredive ndërlidhet edhe me kamatat e kursimeve. Në shtetet e BE-së, qytetarët kanë kursime të mëdha, andaj shteti përpiqet që këto të holla t'i orientojë në konsum, andaj në vend të pagesës së kamatave të kursimeve, bankat evropiane paguajnë për ruajtjen e të hollave të

depozitave. Si rrjedhojë e kësaj, edhe kamatat e kredive janë më të ulëta në shtetet evropiane.

Por megjithatë, edhe në shtetet evropiane ka dallime në kamatat në varësi prej më shumë faktorëve. Andaj, edhe kamatat më të ulëta janë shënuar në Francë me 1.66 për qind dhe Gjermani me 1.76 për qind. Luksemburgu, Austria, Sllovakia dhe Belgjika kanë pasur në mesatare kamata nën 2 për qind apo prej 1.93 deri 1.96 për qind. Normat e interesit apo kamata më të larta janë në Greqi me 5.02 dhe në

Në Gjevgjeli kapen 83 emigrantë

Gjevgjeli, 23 shtator - Policia e Maqedonisë sot tek fshati Smokvicë, ka gjetur 83 emigrantë të paligjshëm, nga të cilët 11 persona minore, në një automjet me rimorkio pronësi e një ndërmarrje dhe të drejtuar nga një qytetar i Gjevgjelisë. MPB-ja kumtoi se sot në mëngjes në orën 8:10 minuta në afërsi të fshatit Smokvicë, policë nga Stacioni policor për mbikëqyrje kufitare dhe kontroll kufitar "Bogorodicë" kanë penguar kontrabandimin e emigrantëve nga një automjet transportues me rimorkio me targa të Gjevgjelisë pronësi e një ndërmarrje, ndërsa të drejtuar nga shoferi R.R. nga Gjevgjelia. Në hapësirën transportuese të automjetit, janë gjetur 83 emigrantë të paligjshëm nga të cilët 11 ishin minore. Dhjetë nga personat minore ishin nga Pakistani dhe një nga Afganistani, ndërsa ndër 72 emigrantët e rritur, katër ishin nga Iraku, një nga India, një nga Afganistani dhe 66 nga Pakistani. Shoferi është marrë për procedurë të metutjeshme, ndërsa personat për momentin gjenden në Qendrën e pranimit në Gjevgjeli, kumtoi MPB-ja.

KONSTANTINOS SELCAS PËR MIA-n

Marrëveshja e Prespës në dobi të të dy popujve

Athinë, 23 shtator - Marrëveshja e Prespës është pozitive dhe në interes të dy popujve, mendon deputeti i partisë qeveritare SYRIZA, Konstantinos Selcas. Në një intervistë për MIA-n, ai shpreket se të dyja palët do t'i përfundojnë me sukses obligimet e parashikuara dhe marrëveshja do të zbatohet, sepse shtetet fqinje duhet të jenë shtete mike.

"Marrëveshja e Prespës është avantgardë dhe marrëveshje në interes të dy popujve, nga kjo marrëveshje do të kenë përfitime që të dy shtetet dhe të dy popujt në progres të përbashkët në Bashkimin Evropian. Do ta karakterizojë këtë si shumë pozitive dhe personalisht ju uroj dy kryeministrave që kontribuuan në këtë drejtim", citon Selcas në intervistë. Ai është i bindur se edhe përkundër vështirësive nga të dyja palët në fund do të fitojë logjika, do të fitojë e ardhmja e përbashkët duke shtuar se nuk ekziston

mënyrë tjetër përveç kësaj që të gjendet një zgjidhje e përbashkët. "Mendoj se nuk është në interes që të mos gjejmë zgjidhje, sepse nuk mundet të presim më tepër, duhet të fitojmë miq, ndërsa mik është gjithmonë fqinji, kështu që në çfarëdo lloj mënyre kjo Marrëveshje duhet të kalojë", thotë Selcas.

Në pyetjen për disa projekte konkrete ai u përgjigj se kanë biseduar për bashkëpunim që duhet të jetë bashkëpunim parlamentar që të përafrohemi, që siç thotë ai, ta njohim fqinjin dhe ta shohim kush jemi dhe çfarë kërkojmë. Ai foli edhe për reagimet në të dyja vendet duke i cilësuar si nacionalizëm nga të dyja palët, dhe se njëra anë e ushqen anën tjetër.

Në pyetjen e fundit se çfarë do t'i rekomandonte fqinjëve një javë para referendumit deputeti i SYRIZA-s thotë



se e nevojshme është që javën e ardhshme, PRO-ja për referendumin të fitojë shumicën dërmuese duke shprehur edhe mendimin e tij se edhe ai është për "PRO".

Nëse shqyrtohet mundësia që fermat e bujqve të transferohen jashtë fshatrave, atëherë duhet që shteti në mënyrë serioze të ndihmojë në kyçjen e re të rrymës që kushton nga 8 deri 10 mijë euro, të mbulojë harxhimet e furnizimet me ujë, si dhe të rivlerësojë subvencionet për lopë dhe dele

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 shtator - Fermerët e Maqedonisë nuk mund të bëhen më evropian se fermerët në Evropa. Kështu vlerësohet paralajmërimi për legalizimin e fermave bujqësore e që nënkupton edhe zhvendosjen e fermave jashtë kufijve të fshatrave të banuar, ku pjesa më e madhe janë momentalisht. Një pjesë e përfaqësuesve të bujqve në vend thonë se në këtë mënyrë, faktikisht mjediset rurale po trajtohen si urbane. Sipas anëtarit të Këshillit drejtues së Federates së Fermerëve të Maqedonisë, Memet Sinani, madje edhe në Zvicër apo Gjermani, të gjithë e dinë se çfarë prodhimtarie serioze bujqësore kanë, punojnë fermat midis fshatrave duke mos i penguar askujt. Gjithashtu, ata fitojnë edhe ndihmën e madhe të shtetit lidhur me infrastrukturën e nevojshme për ekzistimin e tyre.

"Ne dëshirojmë të bëhemi më Evropë se Evropa nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, na mungojnë kushtet themelore për këtë gjë. Nëse shqyrtohet mundësia që fermat e bujqve të transferohen jashtë fshatrave, atëherë nevojitet që shteti në mënyrë serioze të ndihmojë në kyçjen e re të rrymës që

BUJQIT SKEPTIK NË LEGALIZIMIN E EKONOMIVE BUJQËSORE



MË EVROPË SE EVROPA

kushton së paku 8 deri 10 mijë euro, të mbulojë harxhimet e furnizimit me ujë për shkak se fermerët thjeshtë nuk kanë mundësi të paguajnë këto harxhime për fermat e reja e kështu me radhë", thekson Sinani. Ai përshëndet pagesat deri në fund të subvencioneve për fermerët, por megjithatë shton se nevojitet të rishqyrtohet shpërndarja e subvencioneve në favor të rritjes së cilësisë së prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale.

"Nevojitet të ndryshohet metodologjia e pagesës së subvencioneve për prodhimin e grurit në bazë të sasisë së dorëzuar tek grumbulluesit, dhe jo sipas hektarit të tokës. Kjo do të anulohet një anomalie ku prodhuesi i grurit në Pellagoni për

7000 deri 8000 kilogramë fiton nga 1 denarë për kilogram, ndërsa prodhuesit në Ovçe Pole për shembull fitojnë për 1000 deri 1200 kilogramë nga 8-9 denarë për kilogram", shton Sinani. Nevojitet të rriten edhe subvencionet për kultivuesit e lopës në raport me kultivuesit e dhenve.

"Përlllogarit se një lopë është e barabarte me dhjetë dele. Si ka mundësi atëherë që për një lopë të fitohen 40 euro subvencion, kur ajo ka vlerën e 700 deri 800 euro, ndërsa për një dele që ka vlerën prej 70 deri 80 euro, të fitohen 16 euro subvencione. Andaj, ky raport për subvencionet duhet të ndryshohet në 15 euro për një dele dhe 150 euro për një lopë", shpjegon Sinani ne-

vojën që më shumë të mbështeten kultivuesit e lopëve në Maqedoni.

Lidhur me problemet e tjera me fitimin e subvencioneve, ai thotë se shpesh shteti nuk ka faj që bujqit punojnë nga dhjetë hektarë tokë të huaj, ndërsa marrin subvencione vetëm për dy hektarë tokë që i kanë në pronësi të tyre. Andaj, vetë bujqit duhet të angazhohen të zgjidhin çështjet e tyre pronësore-juridike me qëllim që në mënyrë maksimale të shfrytëzojnë subvencionet për tokën bujqësore që e punojnë. Sinani më tej shton se shteti duhet më shumë të kontrollojë se sa subvencionet shkojnë në duart e fermerëve të vërtetë dhe sa tokë shtetërore me qira ju ndahet bujqve që me të vërtetë jetojnë nga buj-

qësia apo atë e kanë veprimtari kryesore ekonomike.

Ndryshe, idenë për zhvendosje të fermave jashtë kufijve të fshatrave të banuar e kanë hedhur si mendim përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, pasi sipas tyre, fshatrat do të modernizoheshin dhe do të rritej mundësia për kultivim, kryesisht të blegtorisë më rahat dhe pa i penguar askujt.

Nga kjo ministri kanë kumtuar gjithashtu se deri më 1 shtator të këtij viti, janë paguar 99 për qind e subvencioneve të vitit të kaluar, apo me fjalë të tjera - bujqit kanë fituar 6.8 miliardë denarë, ndërsa ka paralajmërim se subvencionet do të rriten edhe më shumë vitin e ardhshëm.

ME DRU APO RRYMË?

Qytetarët kanë filluar të mendojnë për dimrin

Druri i ahut shitet me çmim prej 3000 denarësh jashtë sezonit, ndërsa gjatë sezonit - çmimi i tyre rritet në 3200 denarë për metër katror. Dushku këtë vit shitet prej 3300 deri 3400 denarë për metër katrorë

Koha Aida XHONI

Shkup, 23 shtator - Vjeshta në Maqedoni dhe në hemisferën veriore të Tokës filloi dje. Edhe pse dimri është larg, nikoqirët e shtëpive me të madhe kanë filluar të përgatiten për ditët e ftohta të dimrit. Llogaritë e "trasha" të rrymës kanë detyruar një numër të madh qytetarësh këtë vit të vendosin të ngrohen me drunj. Nëpër rrugët e Shkupit mund të shihen dru të prerë ose të radhitura. Gjithashtu, është rritur edhe numri i kamionëve nëpër rrugët e Shkupit të cilët dërgojnë dru tek qytetarët.

"Druri i ahut shitet me çmim prej 3000 denarësh jashtë sezonit,

ndërsa gjatë sezonit çmimi i tyre rritet 3200 denarë për metër katror. Dushku këtë vit shitet prej 3300 deri 3400 denarë për metër katrorë. Kjo është periudha kur qytetarët fillojnë të blejnë dru për ngrohje, pasi tani çmimet janë më të ulëta. Prandaj tani presim të kemi më shumë punë, sepse gjatë sezonit dimërore qytetarët vetëm blejnë një metër ose dy metër kub shtesë që tu gjinden për çdo rast", thonë shitësit e drunjve. Qytetarët blejnë, por pjesë e tyre kanë përvojë të keqe nga shitësit privat, të cilët në llogari të çmimit më të ulët mashtrojnë duke dhënë më pak nga një metër kub.

"Drunjtë që i ofrojnë shitësit

privat me të vërtetë janë më të lirë dhe na i sjellin deri në shtëpi falas, nëse nuk i hap mirë sytë, ata do t'hapin. Ne i blejmë drunj të zakonshëm në këtë periudhë, sepse ashtu siç afrohet sezoni i ngrohjes rriten edhe çmimet", thotë një banor i Lisiçes. "Kemi eksperimentuar shumë me ngrohjen, dhe vendosëm këtë vit të ngrohemi me drunj, sepse ngrohja qendrore me rrymë vitin e kaluar na kushtoi shumë. Punuam vetëm ti paguajmë llogaritë të cilat ishin shumë të larta. Këtë vit blemë dhjetë metër kub dru që na kushtuan 30.000 denarë, edhe pse paratë i dhamë përnjëherë, kjo është variant më i lirë", tha një banor i Butelit.



"Ende nuk kemi blerë drunj, por me rrymë nuk ngrohemi pasi edhe ajo është shtrenjtë. Drunj do ti blejmë kah mesi i tetorit, kjo është alternativa e vetme", tha një qytetar tjetër.

Ndryshe, një hulumtim i UNDP-së, i publikuar në nëntor të

vitit të kaluar nxori në pah se 45 për qind e amvisërive ngrohen me dru ose me materie të tjera të dëmshme për ajrin. Shkupi shpenzoi 370.000 tonë dru për ngrohje që është e barabartë me numrin e drunjve në vit që ndodhen në Vodno.

KRONIKË

Për 5 ditë, zbulohen 121 emigrantë në Llojan

Policia ka penguar hyrjen e paligjshme në Maqedoni nga Serbia të 121 emigrantëve tek pika kufitare në lëvizje nga Miratoci (fshati Llojan) deri tek autostrada nga data 18 e këtij muaji e deri më sot. Prej tyre 112 ishin nga Irani, gjashtë nga Afganistani, ndërsa tre nga India. Aktivitetet janë zbatuar nga nëpunësit policorë nga Stacioni policor për mbikëqyrje kufitare "Sopot".

Gjobiten 55 shoferë të dehur

Prania e alkoolit në gjak është konfirmuar tek 55 nga gjithsej 133 shoferë tek të cilët është zbatuar testi i përdorimit të alkoolit, ndërsa një shofer ka refuzuar të testohet, në aksionin policor të zbatuar mbrëmë nga ora 23:00 e deri në orën 05:00 të mëngjesit. Janë ndërmarrë edhe 55 masa për kundërvajtje nga Ligji për siguri në komunikacionin rrugor dhe Ligjin për automjete ndaj shoferëve, janë përjashtuar 56 shoferë nga komunikacioni, përkohësisht janë marrë 55 patentë shoferi, janë dhënë 55 urdhër pagesa, një urdhërpagesë kundërvajtëse dhe janë zbuluar 75 kundërvajtje tjera. Gjatë ditës së djeshme, 80 shoferë e kanë tejkaluar shpejtësinë në vend të banuar. Janë ndërmarrë 80 masa lidhur me kontrollin e aksionit, janë dhënë 70 urdhërpagesa, dy urdhërpagesa kundërvajtëse, paralajmërim me shkrim për tetë shoferë, janë zbuluar 32 kundërvajtje tjera, janë dhënë 17 urdhërpagesa dhe 15 urdhërpagesa të detyrueshme, informuan nga MPB-ja.

Digjet një pjesë e klubit "Stacioni 26"

Është djegur salla dhe një pjesë e hollit në klubin e natës "Stacioni 26" në rrugën "Jordan Mijalkov" në Shkup. Komandanti i Brigadës për mbrojtje kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit, Zvonko Tomeski deklaroi për MIA-n se zjarri ka shpërthyer pasdite, ndërsa intervenimi ka përfunduar. "Në shuarjen e zjarrit kanë intervenuar dhjetë zjarrfikës me katër automjete të zjarrfikësve", deklaroi Tomeski. Tani për tani nuk dihen arsyet për zjarrin. (O.Xh)

MAQEDONIA ME KAPACITETE TË PAMJAFUESHME

BUKA VARET NGA IMPORTI



Sivjet, Ministria e Bujqësisë me një shumë prej katër milionë euro, me rritjen e subvencioneve për grurin e prodhuar dhe të dorëzuar, do të ndihmojë si prodhuesit vendor të grurit ashtu edhe mullisët në Maqedoni

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 shtator - Maqedonia vite me radhë nuk arrin ta sigurojë bukën për nevojat e saja vetëm nga prodhimtaria vendore e grurit. Në nivel vjetor shteti ka nevojë për afër 339 mijë tonë grurë, prej të cilave, 280 mijë tonë nevojiten për prodhimin e bukës dhe parodive të bardha, afër 32 mijë tonë nevojiten për materiale të mbjelljes dhe afër 18 mijë tonë shkojnë për rezervat shtetërore.

Maqedonia në vitet e kaluara përmbushte nevojat e saja për grurë në mesatare prej 60 për qind, ndërsa pjesa e mbetur importohet nga jashtë. Thënë ndryshe, nga prodhimtaria vendore sigurohen afër 200 mijë tonë grurë, ndërsa nevojat prej afër 100 mijë tonë të grurit dhe miellit plotësohen me importin nga Serbia, Bullgaria, Kroacia etj.

Problem tjetër i prodhimtarisë vendore të grurit është edhe rendimenti mesatar prej afër tre tonë për hektarë si dhe ulja e madhe e tokës bujqësore që punohet në vend. Analizat tregojnë se rreth një e treta e tokës bujqësore në Maqedoni nuk punohet, si rrjedhojë e orientimit të rinjve në mërgim dhe uljes së fuqisë së aftë punuese në viset rurale, uljes së natalitetit, kostos së lartë të prodhimtarisë bujqësore etj. Gjithashtu në gati 30 vitet e kaluara në shtet shënohet ulje e madhe e sipërfaqeve të mbjella prej grurë. Sipas statistikës zyrtare në 25 vitet e kaluara tokat e mbjella me grurë janë zvogëluar për afër 33 mijë hektarë apo me fjalë tjera është regjistruar ulje prej 113 mijë hektarë të tokës së mbjellë me grurë në 80 mijë hektarë në vitin 2016.

Agronomët thonë se mbulimi i pjesës dërmuese të grurit për nevojat e vendit kërkon edhe mbjel-

ljen e sortave të reja që do të jetë më rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, përdorimin e materialit të farave të certifikuara, si dhe shfrytëzimin sa më të madh të masave moderne agroteknike lidhur me lëvrimin dhe punimin e tokës, plehërimin para mbjelljes, ushqimit eventual gjatë vegjetacionit nëse mungon karboni etj. Gjithashtu rekomandohen edhe këshillimet më të shpeshta për fermerët me qëllim të dinë se me cilat preparate kimike të trajtojnë kultura bujqësore në varësi prej sezonit me më shumë diell apo më shumë thatësi.

"Maqedonia vite me radhë nuk kënaq nevojat e saja të grurit për prodhimin e bukës, andaj nevojitet që maksimalisht të shfrytëzohet kushtet e ndryshme për rritjen e prodhimtarisë vendore të grurit për çka ndahen mjete të mëdha për import. Në këtë drejtim nevojitet që të aktivizohen tokat që nuk punohen dhe që janë të përshtatshme për mbjelljen e grurit si dhe të vendosen teknologji dhe sorta të reja që do të japim edhe rendimente më të mëdha", thotë profesori universitar Boris Anakiev.

Nga ana tjetër, profesori universitar Dane Boshev thotë se Maqedonia nevojitet ti kushtojë një vëmendje më të madhe kënaqjes së nevojave të saja për grurë për shkak se mund të ndodhin luhajtje të mëdha të çmimeve të drithërave në bursat botërore dhe shtrënjtimit i grurit si prodhim që tregtohet në bursë.

"Rendimentet jo të kënaqshme, por edhe cilësia që dikton në fund edhe çmimin në treg janë disa nga problemet kryesore të grurit të prodhuar në Maqedoni. Rritja e prodhimtarisë vendore krahas asaj se varet edhe nga kushtet klimatike, mund të reali-

zohet në rast se përdoren fara cilësore, periudhë e përshtatshme për mbjellje, masa bashkëkohore të prodhimit, përfshi edhe ato të mbrojtjes së bimëve", thekson Boshev.

Sipas tij, nevojitet të kryhet edhe analiza e trullit për të ditur se cilat lloje të plehrave duhet të përdoren për kultivimin e grurit, ndërsa një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet edhe punimit të tokës, ushqimit të trullit si dhe mos-ngarkesës së tokës duke e mbjellë arrën vite me radhë me një kulturë të njëjtë.

Ndryshe, sivjet Ministria e Bujqësisë me një shumë prej katër milion euro, me rritjen e subvencioneve për grurin e prodhuar dhe të dorëzuar do të ndihmojë si prodhuesit vendor të grurit ashtu edhe mullisët në Maqedoni. Me masën e parë do të rritet minimumi i hapësirave të paraqitura për fitimin e totalit të shumës së programuar të subvencioneve për kulturat bujqësore. Kjo me fjalë tjera, do të thotë se nëse deri tani 100 për qind të subvencioneve i kanë fituar bujqit që kanë paraqitur 0.3 deri më 10 hektarë, në të ardhmen për këtë kategori të bujqve do të paguhet 100 për qind e subvencioneve për hapësira të paraqitura deri më 20 hektarë.

Lartësia e subvencioneve për tokën e paraqitur bujqësore më të madhe se 100 hektarë, në vend 10 për qind të subvencioneve, do të jetë 20 për qind. Kjo masë do të dedikohet kulturave bujqësore që do të ndihmojnë rritjen e qëndrueshmërisë së prodhimtarisë vendore grurit dhe kulturave të tjera bujqësore si dhe përmirësimin të konkurrencës së bujqësisë vendore. Gjithashtu çdo grumbullues i grurit i regjistruar në regjistrin e grumbulluesve që do të blejë grurë vendor të korrijës së vi-

BORIS ANAKIEV

Maqedonia vite me radhë nuk kënaq nevojat e saja të grurit për prodhimin e bukës, andaj nevojitet që maksimalisht të shfrytëzohet kushtet e ndryshme për rritjen e prodhimtarisë vendore të grurit për çka ndahen mjete të mëdha për import. Në këtë drejtim nevojitet që të aktivizohen tokat që nuk punohen dhe që janë të përshtatshme për mbjelljen e grurit si dhe të vendosen teknologji dhe sorta të reja që do të japim edhe rendimente më të mëdha

tit 2018 dhe atë më së voni deri më 15 shtator, do të fitojë subvencion prej një denarë për një kilogram grurë. Para dy vitesh, shteti intervenoi me 6000 denarë për hektar, apo dy denarë shtesë subvencion për kilogram për bujqit që kishin paraqitur prodhimin, si mbështetje për prodhimtari të qëndrueshme dhe për mbjellje edhe në vitin e ardhshëm. Kjo ishte një nga masat me të cilat shteti ndihmoi që fermerët të fitojnë së paku 11 denarë për kilogram të grurit të bukës, pas paralajmërimit të mullisëve në vitin 2016 se do të grumbullojnë çmimin me më së shumti tetë denarë për një kilogram. Në vitet e kaluara me qëllim të stabilizimit të tregut vendor të grurit në fuqi ishte edhe obligimi i përkohshëm që parashikonte se bizneset që do të importojnë një kilogram grurë, duhet të blejnë tre kilogramë grurë vendor, apo në rast se importojnë një kilogram miell, duhet të blejnë katër kilogram grurë.

DEFEKTET E NJËPASNJËSHME NË STACIONIN PËR GRUMBULLIM

TETOVA NË HALL ME MBETURINAT

Nga Eco Guerilla theksuan se komuna nuk është e aftë që të menaxhojë me mbeturinat dhe duhet që pushteti qendror t'ia merr ingerencat Komunës së Tetovës në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe vetë organizojë të njëjtën



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 shtator - Për herë të tretë, Stacioni për grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave në Tetovë është në defekt. Kjo ka bërë që edhe grumbullimi i mbeturinave të shënon ngecje në qytet. Vonesat kanë bërë që në shumë pjesë të qytetit të Tetovës të hasen kontejnerë të stërbushur me mbeturina. Ndërmarrja Publike Komunale në Tetovë has në vështirësi që të mbeturinat ti transportojnë në Drislla, dhe në këtë mënyrë ta-

shmë stacioni për ngarkim dhe shkarkim është rikthyer në deponi të vërtetë, por edhe nëpër qytet situata paraqitet e vështirë.

Nga Eco Guerilla theksuan se komuna nuk është e aftë që të menaxhojë me mbeturinat dhe duhet që pushteti qendror t'ia merr ingerencat Komunës së Tetovës në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe vetë organizojë të njëjtën. Kanë kaluar dhjetë vite që kur Te-

tova ishte ngulfatur nga mbeturinat, pasi të njëjtat ishin grumbulluar afër stacionit hekurudhor në Tetovë. Pothuajse që atëherë e këndej problemi me mbeturinat e përkohshme shfaqet kohë pas kohe. Në këtë drejtim janë edhe shqetësimet e shoqatave joqeveritare, të cilët kërkojnë që ky problem të zgjidhet urgjentisht. Përndryshe, mbeturinat nga rajoni i Pollogut vazhdojnë të mos tran-

sportohen në deponinë Rusino të Gostivarit. Nga NPK-ja thonë se krahas vështirësive për të transportuar mbeturinat në Drislla në Shkup, po ashtu edhe stacioni në Tetovë është në defekt. "Ndërmarrja që bart mbetjet nga Tetova në Shkup ka pasur probleme para disa ditësh, por ndërmarrja jonë u detyrua që të bëj deponimin e mbetje këtu tek ngarkim-shkarkimi. Por edhe ne kemi pasur defekt teknik që shpresojmë shpejt ta rregullojmë, kjo është përditshmëri e jona, ne kemi defekte shpesh dhe shpejt besojmë ta rregullojmë problemin e mbetjeve që janë grumbulluar në këtë vend", thonë nga NPK "Tetova-Tetovë".

Aktualisht, në Tetovë grumbullojmë rreth 250 ton mbeturina brenda ditës. Përndryshe, mbeturinat nga rajoni i Pollogut vazhdojnë të mos transportohen në deponinë Rusino të Gostivarit. Gjatë kohës kur Stacioni për ngarkim dhe shkarkim që ndodhet në rrugën Tetovë-Trebosh është në defekt, grumbullimi i mbeturinave është kryer me shumë vështirësi, pasi që është dashur që mbeturin-

at të transportohen direkt në Drislla, derisa është rregulluar defekti në këtë stacion ngarkim shkarkim. Një kohë të gjatë mbeturinat transportohen për në deponinë Drislla, që është shumëfish më e shtrenjtë për shkak të distancës dhe përderisa nuk merr epilog deponia në Gostivar, Tetova dhe Komunitat e Pollogut do të dërgojnë mbeturina në Drislla dhe kjo në masë të madhe ndikon që komunat të mos mund të menaxhojnë mirë me mbeturinat në këtë rajon që ka rreth 170 mijë banorë. Gjatë verës së vitit të kaluar, ky stacion u lëshua në përdorim, por faza e dytë nuk ka filluar ende të rregullohet, që është faza e selektimit. "Faza tjetër e këtij projekti është sa i përket selektimit. Në këtë vend është përmbledhja e mbeturinave në përbërje të plotë dhe transportimin e tyre, kurse me fazën e dytë shohim që të bëjmë edhe selektimin e mbeturinave që mendojmë se do ndihmojë akoma më tepër ndërmarrjen publik", kishte deklaruar në atë kohë kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi.

Publicitet



FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

Adresa: Rruga „23 Oktomri“ nr. 11, 1000 Shkup; E-mail: info@piom.com.mk
Qendra Tel: (02) 3250-100; Fax: (02) 3162-275; Komisionet Invalidore Tel: (02) 3065-184

LAJMËRIM PËR SHPALLJE

Për dhënie me qira të hapësirës afariste përmes ankandit publik elektronik

Lajmërohen të gjithë subjektet e interesuara juridike dhe fizike (të vendit dhe të huaj) se, **Fondi për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, publikon Shpallje nr. 04/2018 për dhënie me qira të hapësirës afariste, përmes ankandit publik elektronik**, në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18) dhe Rregullores për mënyrën dhe kushtet për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi ose shfrytëzim të përhershëm të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 197/14 dhe 176/15).

Shpallja për dhënie me qira të hapësirës afariste është publikuar në ueb faqen e sistemit elektronik për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste: www.deloven-prostor.mk dhe në ueb faqen e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë: www.piom.com.mk më datë **24.09.2018 (e hënë)**.

Informatat më të detajuara mund të merren në zyrat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe në telefonat në vijim: 3250-404, 070/360-243 (Ajredin Amzai) dhe 3250-440, 071/392-576 (Luben Veljanoski)

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë
Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik

Në bazë të nenit 17, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet e tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore, si dhe programit vjetor për punë të SHFK "Vojdan Çernodrinski" Shkup, rr. Drezdenska nr. 3, tel: 02/ 3066 610, në vijim publikon:

SHPALLJE

Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet e tjera për nxënësit për vitin shkollor 2018/2019

Furnizues:

SHFK "Vojdan Çernodrinski" Shkup, me seli në rr. Drezdenska nr. 3, 1000 Shkup, tel: 02/ 3066 610

Ofertes:

Subjektet e vendit juridike

Lënda e furnizimit:

1. Verim njëditor me nxënësit e klasës së VIII dhe IX

Lokacioni vjeshtor: Markov Manastir, (koha e relacionit: tetor 2018)

2. Verim njëditor me nxënësit e klasës së VIII dhe IX

Lokacioni pranveror: Pelenicë, (koha e realizimit prill, maj 2019)

3. Ekskursion njëditor mësimor – shkencor për nxënësit e klasës së III – relacioni Shkup, Mavrovë, Shtegu i Petkos, Shkup.

Koha e realizimit maj 2019.

4. Ekskursion dyditor mësimor – shkencor për nxënësit e klasës së VI

Lokacioni për vizitë: Shkup, Dojran, Strumicë, Shkup.

Koha e realizimit: tetor 2018/maj 2019

5. Ekskursion treditor mësimor – shkencor për nxënësit e klasës së IX

Relacioni: Shkup, Manastir, Krushevë, Ohër, Vevçani, Strugë, Ohër, Shkup.

Koha e relacionit: tetor 2018/maj 2019.

6. Mësim në natyrë për klasën e V (3 ditë)

Lokacione për vizitë: Shkup, Tetovë, Mavrovë, Vevçani, Ohër, Strugë, Ohër, Shkup.

Koha e relacionit: maj 2019

7. Pushim dimëror – për nxënësit e klasës VI deri IX

Lloji i shërbimit: transport, akomodim, ushqim

Lokacioni: Qendra turistike – Krushevë, Mavrovë

Lokacioni e bujtje: hotelet: Montana, Makpetrol.

Koha e relacionit: janar 2019, shtatë ditë.

8. Verim

Lloji i shërbimit: transport, akomodim, ushqim

Lokacioni: Ohër

Koha e relacionit: qershor/korrik 2019, shtatë ditë,

Lokacioni për bujtje: Ohër, hotelet: Klimetica, Desaret, Beton

Kushtet për transport:

-Mjetet transportuese – (autobusë, ndërsa sipas nevojave edhe minibusë) të kenë numër të mjaftueshëm të ulësve – për secilin nxënësit veç e veç.

-Të posedojnë dëshmi për rregullësi teknike të jashtëzakonshme të makinave për transport publik në pajtim me ligjet valide ekzistuese në Republikën e Maqedonisë dhe

-procesverbal për kontroll të jashtëzakonshëm teknik të autobusit – minibusit, jo më të vjetër se 6 muaj, i cili do të dorëzohet për tu parë para realizimit të udhëtimit.

Kushtet për akomodim:

Objektet me (2) dy dhe (3) tre yje, në dhoma me 2-3 krevate në bazë të pansioneve të plota. (Gjatë çmimeve të ngjashme dhe të njëjta, ofertat për objektet me 3 (tre) yje do të kenë përparësi).

Kriteret për ofertesin:

-Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike (Vendim nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë)

-Të ketë së paku tre vërtetime për realizim të suksesshëm të ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira në vitin e fundit, të nënshkuara dhe të vërtetuara nga subjektet për të cilat është realizuar shërbimi.

-Të përmbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Oferta në pajtim me kërkesat e furnizimit duhet të përmbajë:

-emri i subjektit juridik, nënshkrim i personit përgjegjës dhe vulë;

-çmim individual dhe të përgjithshëm të shërbimit për nxënësit (akomodim, transport dhe ushqim);

-kushtet të vulltshme për nxënësit që vijnë nga familjet e prekura sociale

-kushtet për akomodim, meny për ushqim dhe transport;

-çmimi të përfshijë edhe sigurim të posaçëm të nxënësitve;

-menyra e pagesës;

-udhërrëfyes dhe mjek;

-të posedojë dëshmi për qira të objekteve në pajtim me kushtet e theksuara për akomodim;

-Dëshmi për transport të siguruar në pajtim me kushtet e theksuara për transport.

-Garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 5% nga vlera e marrëveshjes (dorëzohet ofertesuesi i zgjedhur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes)

Subjektet e interesuara juridike të dorëzojnë ofertat e tyre deri në SHFK "Vojdan Çernodrinski" – Shkup

rr. "Drezdenska" nr. 3 Shkup personalisht në zarf të mbyllur me shenjë – Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursion.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh.

SHFK "Vojdan Çernodrinski"
rr. "Drezdenska" nr. 3 Shkup

Më 30 shtator ti vendos
për ardhmërinë tënde!

**DIL PËR
MAQEDONINË EVROPIANE!**



www.izleziza.mk

PO



Nga
Shaqir ISLAMI

Shtator, a bën mot të ngrohtë vere! Aq vite mbaj në shpinë, nuk mbaj mend Shtator më të bukur! Dhe i bereqet-shëm! Molla, dardha, groshë, gështenja, arra, lajthi, ... bollëk. Ky vendi ynë është një xhenet i vogël! Po, nuk e them vetëm unë, kështu na thonë të huajt. Ne as që jemi të vetëdijshëm se jetojmë në një vend të bukur. Sharrri plak, tërë verën dhe tani vlon nga mysafirë të huaj. Ata s'mund të ngopen me bukuritë dhe begatitë e tij. Duhet të vinë të huajt dhe të na tregojnë se jetojmë në një shtet të vogël, por të begatë me bukuri të rralla dhe bereqet të bollshëm.

Ne, na duhet shumë pak për lumturi! Me një PO në referendumin e 30 shtatorit, secili do ngjallë shpresën, optimizmin dhe dashurinë fqinjësore; referendumi i suksesshëm do na sjell nam dhe bereqet. Sa e rëndësishme është një datë dhe një ditë vendimtare. Pra edhe dita dallon nga dita. Secila ditë nuk është njësoj. Kjo ditë peshon shumë-shumë më shumë se çdo ditë e 30. e muajve tjerë. Përfundimisht me këtë referendum, secili nga ne është person i rëndësishëm, fjala e secilit peshon sa edhe një politikani, Hoxhe, akademiku, ... në 30 Shtator mbizotëron barazia e plotë në shoqëri, atë ditë të gjithë e gëzojnë të drejtën e demokracisë, vendosin për fatin e shtetit të tyre; secili e jep kontributin personal dhe familjarë për një të ardhme evropiane, vetes, nipërve dhe mbesave për shumë gjenerata. Të jemi të sinqertë, edhe zogjtë e dinë se mirëqenia në vendin tonë vinë vetëm nga Evropa. Shembull janë gurbetçinjët tanë. Vite me radhë, si milingona të vyeshëm, kanë sjellë mirëqenien evropiane në vendin tonë. Allo, aritmetikë e thjeshtë kjo, duhet vetëm një PO.

Para disa vitesh, me nipin tim Alinë mblidhnim manaferra në Sharr. Buzë kanalit në lartësi mbi 1400 m. të ndërtuar viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, për grumbullimin e ujërave të malit përmes të cilit mbushet me ujë Liqeni i Mavrovës. Rruga gjarpëron si një gjarpër gjigant përreth Sharrit, e cila është e prishur rëndë vende-vende, por akoma shërben për qarkullim. Nga larg i pamë dy çiklistë që vinin drejt nesh. Kur u afruan i pamë se ishin dy të huaj, vinin nga ana e Mavrovës dhe shkonin në drejtim të Tetovës. Pasi u përshën-

detën u ndalën të pushojnë dhe pinë ujë të ftohtë burimi ndër një tufë lajthish të egër.

"Lum ju, -na u drejtua një mjek-rosh - jetoni në këtë parajsë" - tha njëri nga ta. Tjetri shtoi "mal më të bukur nuk kam parë ..." Dhe si zakonisht i huaji pyetet se prej nga vinë. "Jemi nga Sllovenia. Vijmë nga një qytezë Gorica." U habita me lëvdatat e tyre për malin tim - Sharrin! Pasi e njoh çdo cep të Sllovenisë, iu drejtova : "Po, ju keni male shumë më të bukura ...!". Slloveni, nuk e priti ta mbaroj qëndrimin tim, me përlulësi më tha: "Jo mik, ta them sinqerisht, na dy shokët me vite kemi shëtitur në shumë kontinente me biçikletat tona, kemi shkelur shumë male, ... por si mali Sharr nuk kemi parë, bukuri e paparë ... ndërsa, për fat të keq vijmë për herë të parë. Dhe sinqerisht, ky mal është i paparë." Pasi pushuan, sllovenët e vazhduan rrugën e tyre, ne vazhduam të mblidhim manaferrat e shijshme të Sharrit bolemadh. Nuk e di, kështu më thanë vet sllovenët. Nuk e kam me të dëgjuar nga tjerët.

Prandaj me këtë referendum të suksesshëm i japim shansin Sharrit plak që t'ua shpalosë evropianëve

bukuritë e rralla të tij. Sekush ka të drejtën të kënaqet me bukuritë dhe pasuritë e Sharrit. Referendumi do t'i hap dyert. Ata duke ardhur në Sharr do ta sjellin edhe Evropën në vendin tonë. Turizmi është burim i mirëqenies, jo vetëm për ne. Turizmi zhvillon një varg industrish tjera. Kështu krijohen vendet e punës, jo me pallavrat e budallafta të Ali Ahmetit.

Ta them troç, ky referendum duhet të na bashkojë të gjithë: shqiptarë, maqedonas, romë, serb, boshnjakë, Ky është një rast i mirë që ta shkrijmë akullin mes nesh; t'i harrojmë inatet dhe urrejjet, xhelozitë ndaj njëri-tjetrit. Të falim dhe të respektojmë njëri-tjetrin për të mirën e përbashkët. 30 Shtatori është dita e një faqeje të re, pa dallim feje e gjuhe; 30 Shtatori, le të jetë edhe dita e përmirësimit të marrëdhënieve njerëzore, etnike, kombëtare, .. mes nesh dhe fqinjëve tanë. Fqinjësia e mirë është bereqet. Kjo ditë është fletë lakmuri i pjekurisë sonë demokratike, është dita D për ne, pas aq pritje që t'i bashkohemi familjes evropiane. Them PO me plot bindje. Asnjë argument politik s'mund të më bind ndryshe. 30 Shta-

Të gjithë ata që shfaqin dyshime, skepticizëm, defetizëm, rreth këtij referendumi duhet që t'i shmangim sa ma shpejtë. Nëse duhet edhe ta ndërrojmë rrugën. Dita e fundit e këtij Shtatori, do të na i ngrohë zemrat dhe do ta ngjallë shpresën tek qytetarët e vendit tonë. Më në fund, duhet të na prijë oguri i mirë! PO e madhe në 30 shtatorë



tori duhet të jetë një nokdaun për nacionalistët ngado qofshin, dhe për argumentet politike dhe retorikën politike boshe dhe të ligë të tyre. Fuck You, se na i keni shurdhu tashakllarët!

Shtatori edhe politikisht është shumë - shumë i ngrohtë. Ka qarqe që nuk na duan të mirën tonë. Këta balosha duan, të mirën e tyre ta ndërtojnë mbi të keqen tonë. Aman be! Çfarë miqsh të k... na qenkëshkan ! Ne këtë luks s'mund t'ia lejojmë vetes. Ne jemi fukara. Nuk na duhet asnjë miqësi me hile. Këtë herë vet i zgjedhim miqtë. Duhet të jemi syçelë, të mos na ndodh edhe ndonjë 2001'ësh të papritur. Ujët flenë, dushmanët kurrë nuk flenë.

Me sa duket ne nuk kemi vetëm miq, por kemi edhe dushmanë, edhe atë mes nesh. Të gjithë ata që shfaqin dyshime, skepticizëm, defetizëm, rreth këtij referendumi duhet që t'i shmangim sa ma shpejtë. Nëse duhet edhe ta ndërrojmë rrugën. Dita e fundit e këtij Shtatori, do të na i ngrohë zemrat dhe do ta ngjallë shpresën tek qytetarët e vendit tonë. Më në fund, duhet të na prijë oguri i mirë! PO e madhe në 30 shtatorë.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovësja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 23 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirrollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

SANE OBJEKTIVI I ARDHSHËM I JUVENTUSIT

Sulmuesi i talentuar gjerman nuk është duke kaluar momentet më të mira si pjesë e ekipit anglez. Sane ka humbur vendin në formacionin startues tek City këtë edicion, ndërsa në ndeshjet që ka luajtur nuk ka treguar formën më të mirë. Kontrata aktuale e gjermanit me City skadon në verën e vitit 2020 dhe ende nuk ka bisedime për një të re. E këtë po mundohet ta shfrytëzojë Juventus që po mendon për transferimin e tij. Daily Star shkruan se Juventus e pëlqen shumë lojtarin dhe do ta bëjë të pamundurën për ta transferuar në Torino. Zona e Vjetër e sheh gjermanin si zëvendësuesin adekuat të Cristiano Ronaldos për të ardhmen. Problem mbetet shuma e madhe që City e vlerëson talentin e saj rreth 150 milionë euro.



Gasperini e lavdëron Gjimshitin: Është e ardhmja e Atalantës

Berat Gjimshiti ka filluar shkëlqimin në Serie A me fanellën e Atalantës. Pas dy viteve huazim tek Avellino dhe Benevento, mbrojtësi shqiptar është bërë pjesë e rëndësishme e Atalantës. Në ndeshjet e para në Serie A, Gjimshiti ka shkëlqyer me klubin zi kaltër, ndërsa ndeshja e tij më e mirë ishte ndaj Romës kur ndali boshnjakun Edin Dzeko. Për trajnerin e Atalantës, Gian Piero Gasperini, mbrojtësi shqiptar është në mesin e lojtarëve që do të jenë e ardhmja e Atalantës. "Klubi ka bërë investime të mëdha për të ardhmen, por tani duhet të mendojmë edhe për të ardhmen. Lojtarët si Gjimshiti, Mancini, Pesina e Rigoni janë të rëndësishëm për të ardhmen e klubit", ka thënë Gasperini. Skuadra italiane është në bisedime me agjentët e Gjimshitit për vazhdimin e kontratës. Reprerentuesi i Shqipërisë ka një kontratë valide deri në vitin 2019, ndërsa Atalanta po mundohet t'ia vazhdojë edhe për katër vite të tjera. 25-vjeçari pritet të luaj edhe në ndeshjen e sotme ndaj Milanit në San Siro.

"Unë kam biseduar me njerëz nga të dy federatat, por nuk kam vendosur ende. Kam dëshirë të luaj për Kroacinë. E di se nuk e kam pasaportën e Kroacisë, por për tri vjet mund ta marrë atë dhe më pas do të mund të luaj për ekipin kombëtar kroat", u shpreh Kastrati

Sulmuesi i përfaqësueses U-21, Lirim Kastrati, mund të mos vazhdojë rrugëtimin me përfaqësuesen A të Kosovës. Sulmuesi 19 vjeçar vet konfirmoi dëshirën e tij për të mos luajtur për Kosovën në një prononcim për portalin më të madh kroat, Index.hr. Kastrati mbrëmë shënoi golin e dytë të Lokomotiva Zagrebit në duelin ndaj Rijekas tek skuadra e dytë e kryeqytetit kroat vazhdon rrugëtimin drejt titullit. Kastrati

LIRIM KASTRATI: DUA TË LUAJ PËR KROACINË

ti ka shënuar pesë gola këtë edicion, duke qenë golshënuesi i dytë më i mirë në kampionatin kroat. Vet Kastrati në një prononcim pas ndeshjes për Index.hr thotë se dëshiron të luajë për Kroacinë, edhe pse ai është kontaktuar nga Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) dhe Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), që po luftojnë për të. "Unë kam biseduar me njerëz nga të dy federatat, por nuk kam vendosur

ende. Kam dëshirë të luaj për Kroacinë. E di se nuk e kam pasaportën e Kroacisë, por për tri vjet mund ta marrë atë dhe më pas do të mund të luaj për ekipin kombëtar kroat. Në Kroaci futboli është më i mirë dhe më i fortë se në Kosovë dhe Shqipëri e vërtet do të më pëlqente të bart fanellën e Kroacisë", u shpreh Kastrati. Kjo deklaratë e Kastratit është shokuese, sidomos për përfaqësuesen A të Kosovës që

mund të ketë shpresuar në grumbullimin e sulmuesit në top formë për sfidat e radhës në Ligën e Kombeve. Kastrati së fundmi luajti për përfaqësuesen e Kosovës U-21, ku ai asistoi në golin e Florent Hasanit ndaj Irlandës, sfidë që përfundoi me barazim. Deri tash, Kastrati ka luajtur për Shqipërinë U-17 dhe Kosovën U-19 dhe U-21, ndërkaq tash dëshira e vetme për përfaqësuesen A mbetet përfaqësuesja e Kroacisë.

LIGA E PARË - JAVA EVI

Derbi i javës i takon Vardarit

Shkup, 23 shtator - Të shtunën ka nisur java e gjashtë në Ligën e Parë futbolistike të Maqedonisë. Nënkampioni aktual, Vardari ka arritur të shënon fitore si mysafir ndaj Rabotniçkit me rezultatin 2-0. Në derbin e qytetit, kuqezinjët ishin më të mirë në duelin e zhvilluar në stadiumin "Filipi i Dytë", në një përballje me shumë pak raste konkrete. Në minutën e 29 të

takimit ishte Barsegiani që hapi rezultatin për Vardarin, ku dhe me këtë rezultat u mbyllën 45 minutat e para. Në pjesën e dytë ekipi i Vardarit arriti që të rritë epërsinë në 2:0 me anë të Brdarovskit dhe më këtë rezultat u mbyll ndeshja. Ekipi i Vardarit pas kësaj fitore Vardarit aktualisht mban pozitën e parë në tabelë me 14 pikë, 2 më shumë se Akademia Pandev dhe 3



më shumë se Shkendija të cilat kanë nga një ndeshje më pak të zhvilluar. Në javën e shtatë Varda-

ri përballlet me Sileksi, ndërsa Rabotniçi është mysafir i Makedonija Gjorçe Petrovit. (F.N)

Business League, edicioni i 8 me rekord pjesëmarrës



Shkup, 23 shtator - Në vitin e 8 të ekzistimit të saj, gara amatore në futboll të vogël për punonjësit në kompani të ndryshme të Maqedonisë, ose "Biznis Liga", sivjet ka shënuar numrin rekord të ekipeve pjesëmarrëse - plot 25. "Më vjen mirë që këtë vit është një numër rekord të kompanive

pjesëmarrëse dhe shumë kompani të tjera të cilët nuk kishim mundësi që ti pranojmë në këtë garë, por firmosëm kontrata me disa prej tyre për sezonin e ardhshëm. Që do të thotë se Biznis Liga nga viti në vit është më e mirë dhe më e fortë dhe vazhdimisht rritet", tha mes tjerash Filip Nikolovski, menaxher i projektit të "Business League" Të gjitha ekipet pjesëmarrëse do të rreshtohet në një grup, ku secili do të përballlet me secilin, që në fund 4 skuadrat më të mira dhe me më shumë pikë të arkëtuara, do të vazhdojnë fazën e eliminimeve. Sivjet planifikohet që tu jepet mundësi që edhe skuadrat nga pozita e 5-të e deri te ajo e 12-të, që të kenë mundësi të kyçen në fazën e eliminimeve. Organizatorët e këtij eventi sportiv potencuan se për çdo vit shtohet numri i kompanive të interesuara për pjesëmarrjes, andaj mendohet që të zgjerohet edhe numri i pjesëmarrësve në vitet në vijim.

MUNDJE

Fati Vejseli i pesti në botë

Shkup, 23 shtator - Mundësi shqiptarë, Fati Veseli nuk arriti të arkëtojë medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror të mundjes për junior, i cili aktualisht po zhvillohet në Trnava të Sllovakisë. Vejseli në sfidën e repasazhit dhe e vlevshme për medaljen e bronzit, u mund nga mundësi i Moldavisë, Nikolai Grahmez, me rezultat 15-5. Në këtë mënyrë Fati Vejseli shënon rezultatin më të mirë në karrierën e tij, duke u ndalur në vendin e 5-të në botë, në kategorinë stil i lirë dhe në peshat deri më 65 kilogram.



Bayern kërkon të sjellë në Mynih yllin e kombëtares koreane



Bayern Mynih ka shfaqur interes për sulmuesin koreano-jugor Heung-Min Son, që luan me skuadrën e Tottenham në Premier League. Pasi i shpëtoi ushtrisë, koreano-jugori është rikthyer në Londër dhe ka nisur të aktivizohet rregullisht nga trajneri Pochettino, por e ardhmja e tij mund të jetë Bundesliga.

Trajneri Niko Kovac e konsideron si ideal për të zëvendësuar veteranët Robben e Riberry, ndaj dhe është gati të investojë për të marrë 26-vjeçarin. Por duket se Son nuk ka dëshirë të lëvizë nga Londra dhe ka mohuar zërat për një transferim të tij në Mynih. "Sapo kam rinovuar kontratën me Tot-

tenham, jam i lumtur dhe i kënaqur që luaj në këtë ekip. Nuk besoj se do të lëviz, jam fokusuar për të luajtur me Tottenham dhe të jap maksimumin për skuadrën, që besoi tek unë edhe kur nuk isha këtu", tha Son, që i shpëtoi ushtrisë në vendin e tij pas fitores së medaljes së artë në Lojërat Aziatike.

ADEMI DO TË JETË PJESË E CEREMONISË SË ÇMIMEVE TË FIFA-S

Qindra president të federatave kombëtare të futbollit, qindra yje të futbollit, të estradës së muzikës, aktorë dhe njerëz të artit, e në mesin e gjithë këtyre do të jetë i pranishëm edhe presidenti i FFK-së z. Agim Ademi, në gala mbrëmjen e nesërme të FIFA Football Awards, që këtë vit mbahet në Londër



trajneri më i mirë në konkurrencën e meshkujve e ku mëtues janë: Zlatko Daliç, trajner i Kombëtares kroate si nënkampion i botës, ai i kampionit të botës, Francës, Didier Deschamps dhe Zinedine Zidane fitues i Ligës së kampionëve me Real Madridin. Ndërkaq, në konkurrencën e femrave për trajneren më të mirë të botës pretendentë janë: trajneri i Lionit si fitues i Ligës së kampionëve Reynold Pedros, trajnerja e Kombëtares japoneze Asako Takakura dhe trajnerja e Kombëtares gjermane Sarina Wiegman. Presidenti Ademi ka udhëtuar të dielën për në Londër, ndërkaq pas këtij evenimenti më 27 shtator me ftesë të presidentit të FIFA-s Gianni Infantino do të ketë takim në selinë e FIFA-s, e që do të shoqërohet nga sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu dhe ky takim dëshmon përkushtimin e z. Infantino për të thelluar edhe më shumë bashkëpunimin me FFK-në, një anëtare të re të saj.



SPALLETTI: Më shijojnë më shumë këto fitore "in extremis"

Një tjetër fitore "in extremis" për Interin e trajnerit Luciano Spalletti, që pasi triumfoi në sekondat e fundit në Champions League ndaj Tottenham përsëriti të njëjtën skemë edhe ndaj Sampdorias në kampionat. Një gol në minutën e 94-t nga Brozovic i dhanë 3 pikët e radhës në Serinë A skuadrës zikaltër, ndërkohë që nga fusha doli me karton të kuq pikërisht trajneri Spalletti. "Hyra në fushë dhe u drejtova nga telekamera për të bërë për atë gol, ishte një moment shpërthimi. Gjyqtari i katërt më tha se e teprava. Më vjen keq, pasi u interpretua në mënyrë jo korrekte nga gjyqtarët, pasi një gol në ato momente ishte i rëndësishëm, duke parë se na u anuluan dy gola të tjerë", tha Spalletti. "Fitortja në fund të shijon më shumë, pasi këto janë ndeshje ku shpërthen nga gëzimi atëherë kur nuk mendon. Rrezikua disa, por ia dolëm mbanë të fitojmë dhe marrim 3 pikët. Kjo është një skuadër e fortë, me karakter dhe që e tregoi këtë gjë në një fushë të vështirë. Episodet kundër? Nuk i komentoj, jam i sigurt se VAR ka thënë të vërtetën", tha Spalletti.



Të hënën FIFA Football Awards do të jetë një shfaqje me yje në Festivalin Mbretëror të Londrës. Trofe të njëjta do t'i dorëzohen fituesve të çmimeve individuale të futbollistëve dhe trajnerëve të meshkujve dhe femrave. Dizajni i trofeut është topi që u përdor në finalen e parë të Kupës së Botës FIFA ndërmyjet Uruguait dhe Argjen-

tinës në vitin 1930, duke u ulur në majë të një trupi me shkëlqim. Trofeu përbëhet nga pesë pjesë: fundi, baza, një pjesë e karbonit mbi bazën, trupin dhe topin. Pjesa e fundit u krijua duke përdorur një teknologji të përparuar, të përdorur në industrinë e hapësirës ajrore dhe Formula 1. Kështu, presidenti Ademi do të ketë edhe takime

me homologët nga mbarë bota, gjatë përzgjedhjes së futbollistit më të mirë e që në garën finale janë Cristiniao Ronaldo, Luka Modriç dhe Muhamed Salah, ndër meshkuj, ndërsa në konkurrencën e femrave janë futbollistet, norvegjezja Ada Hegerberg, gjermania Dzsniifer Marozson dhe braziliana Marta. Do të zgjidhet edhe

Maradona humbet ndeshjen e parë në Meksikë dhe shpërthen ndaj gjyqtarit

Diego Armando Maradona ka shpërthyer në akuza të forta dhe fyerje karshi gjyqtarit të ndeshjes Aldo Cano, pasi skuadra e tij Dorados u mund 0-1 nga Alebrijes De Oaxaca në kampionatin e Serisë B meksikane. Kjo ishte humbja e parë e legjendës argjentinasë të futbollit në Meksikë, rezultat të cilin Maradona nuk e ka kapërdirë lehtësisht. "Nuk më pëlqen të flas për gjyqtarët,

por për këtë ndeshje nevojitej një gjyqtar tjetër, një gjykim më i mirë. Të dyja skuadrat luajtën mes tyre në mënyrë brutale, madje barbare. Dikush duhej të kontrollonte ndeshjen dhe të vinte rregull. Gjyqtari nuk e bëri asnjëherë këtë gjë, nuk i respektoi rregullat", tha Maradona. Argjentinasi nis kështu polemikat me gjyqtarët edhe në Meksikë, ndërkohë që sipas shtypit vendës

këto janë justifikime për humbjen e tij të parë me ekipin e Dorados. "Nuk dua një futboll të dhunshëm, dua vetëm që të mos përsëriten më në fushë të tilla skena", bërtiste Maradona në momentin që dilte nga fusha e lojës pas ndeshjes. Ndërsa në konferencën e shtypit, Maradona tha se do të përgatisë një raport për këtë gjykim dhe do t'ia dërgojë drejtuesve të FIFA-s.

"Salahu duhet ta fitojë çmimin e FIFA-s, e jo Modrici apo Ronaldo"

Trajneri egjiptian, Hany Ramzy, ka thënë se ai mendon që bashkëkombësi i tij, Mohamed Salah, duhet ta fitojë çmimin për lojtarin më të mirë të vitit të FIFA-s, pasi që ka dhënë më shumë sesa Cristiano Ronaldo apo Luka Modrici. Sulmuesi egjiptian, Salah, kishte arritur t'i shënojë 44 gola në të gjitha garat sezonin e kaluar dhe ai do ta kuptojë nesër nëse do të jetë fituesi i këtij çmimi. Ylli portugez, Cristiano Ronaldo, e ka fituar këtë çmim gjatë dy viteve të kaluara,

dhe tani ai do të kërkojë ta fitojë atë përsëri, pas largimit të tij nga Real Madridi. Ndërsa, deri më tani, çmimet e ngjashme i ka fituar kroati Luka Modrici. "Arsyeja pse unë mendoj se Salahu duhet ta fitojë këtë çmim është për shkak të rrugëtimit që ka bërë deri te këto arritje", ka thënë Ramzy. "Ai u kthye në Angli pas një zhgënjimi me Chelsea dhe u bë golashënuesi më i mirë i Premierligës, si dhe arriti deri në finale të Ligës së Kampionëve dhe e dërgoi Kombëtaren

e tij në Kupën e Botës për herë të parë pas 28 viteve. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur më parë. "Për më tepër, nëse FIFA do ta shikojnë këtë çështje më gjerësisht dhe do t'i konsideronin vështirësitë dhe barrierat kulturore që kanë pasur lojtarët gjatë jetës së tyre, atëherë Salahu duhet të fitojë pa asnjë dyshim". "Ai ka arritur t'i tejkalojë ndarjet kulturore dhe ka pasur një ndikim me të vërtetë pozitiv në lidhjet e njerëzve të ndryshëm me prejardhje të ndryshme".



MIJËRA PERSONA APLIKOJNË SI VULLNETARË PËR KUPËN E BOTËS MË 2022

Të dhënat nga një Komiteti i Dohas kanë thënë se 174,639 persona kanë aplikuar deri më tani për ndihmuar në këtë Kampionat. Të dhënat e komitetit kanë treguar se në mesin e aplikantëve janë 597 sauditë, 380 banorë të Bahreinit dhe 46 të tjerë nga Emiratet e Bashkuara

Pothuajse 175,000 persona kanë aplikuar që të jenë vullnetarë të Kampionatit për Kupën e Botës 2022, duke përfshirë 1,000 persona nga shtetet e Gjirit Arab, të cilat kanë shkëputur të gjitha marrëdhëniet diplomatike dhe ato të udhëtimit me Katarin. Të dhënat nga një Komiteti i Dohas kanë thënë se 174,639 persona kanë aplikuar deri më tani për ndihmuar në këtë Kampionat. Të dhënat e komitetit kanë treguar se në mesin e aplikantëve janë 597 sauditë, 380 banorë të Bahreinit dhe 46 të tjerë nga Emiratet e Bashkuara




ra. Një zëdhënës i Komitetit, i ka thënë agjencisë së lajmeve AFP se aplikacionet kanë ardhur nga banorë me kombësi "të konfirmuar". Këto të dhëna nuk janë verifikuar në mënyrë të pavarur. Arabia Saudite, Bahreini dhe Emiratet e Bashkuara Arabe janë disa prej shteteve që kanë ndaluar bashkëpunimin me Katarin nga qershori i vitit 2017 për shkak të një bllokade politike që ka zgjatur 15 muaj dhe nuk ka treguar asnjë

shenjë të përfundimit. Ky bojkot ka rezultuar me mbyllje të të gjitha lidhjeve tokësore, detare dhe ajrore për në Doha, pas supozimeve se kjo e fundit është duke ndihmuar Iranin dhe grupet ekstremiste islamike. Katari, i cili ka shpenzuar deri më tani qindra miliona dollarë për projektet e lidhura me këtë Kampionat, ka hedhur poshtë vazhdimisht akuzat, duke thënë se rivalët e Gjirit Arab, janë duke tentuar të fitojnë kontrollë mbi politikën e

Jashtme të Dohas. Kampionati i futbollit për Kupën e Botës më 2022 do të mbahet në Lindje të Mesme dhe Katar. Ndërkohë, numri më i madh i personave që kanë aplikuar si vullnetarë ka ardhur nga India, gjithsej 25.000 deri më tani. Është parashikuar që në këtë Kampionat të përfshihen 16,000 vullnetarë, të cilët do të kontribuojnë në një varg sektorësh siç janë shërbimet mjekësore, komunikimi dhe mikpritja.

Një kroat refuzon Realin

Nën-kampioni i botës me Kroacinë, mesfushori Mateo Kovacic, ka deklaruar sot se shprehet i kënaqur që luan në Premier League me skuadrën e Chelsea, duke shpresuar që të luajë me "blutë" e Londrës së më gjatë të jetë e mundur. Ai u transferua nga Real Madrid te Chelsea në fund të merkatos së verës në formë huazimi, çka do të thotë që mund të rikthehet në "Santiago Bernabeu" sërish në fund të sezonit. "Jam shumë i lumtur te Chelsea, një qytet fantastik, fansat janë të mrekullueshëm, stadiumi krijon një atmosferë magjepsëse. Gjithçka është e përkryer për mua dhe e imagjinoj veten duke luajtur për shumë kohë këtu", u shpreh Kovacic, duke lëshuar sinjalet e para të dashurisë për Chelsea, ku së fundi po luan titullar nën urdhrat e trajnerit Sarri. Kovacic, në bazë të kontratës së huazimit që kanë dy ekipet, mund të rikthehet te Reali në fund të këtij sezoni, por mesfushori 24-vjeçar duket se ka dëshirë që të vazhdojë të luajë për Chelsea, ku duket se ka më shumë mundësi për t'u aktivizuar. Ndërkohë që te Reali ishte më së shumti në stol dhe aktivizohej shumë pak.



Emery i vë syrin një trofeu: E di se si fitohet

Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, beson se skuadra e tij do të mbyllë këtë sezon të Premier League në "top-4", pra mes skuadrave që sezonin e ardhshëm do të luajnë në Champions League. Një rezultat ky që trajneri e konsideron si të rëndësishëm në sezonin e tij të parë në Premier League. Jo vetëm kaq, por Emery beson se "topçinjtë" do të arrijnë të fitojnë një trofe në fushë, atë të Europa League, duke qenë kompetitivë në çdo turne që do të luajnë. Suksesi në Europa League do t'i hapë gjithsesi derën për të luajtur në Champions, duke



qenë se fituesi ngjitet një "kategori" më lart. "Për mua, Europa League është shumë e rëndësishme,

por preferoj të luaj Champions. Mendoj se duke qenë kompetitivë në të dyja këto kompeticione do të

arrijmë të shkojmë deri në fund. Unë di se si ta fitojmë turneun europian", tha Emery, që e ka fituar 3 herë radhazi Europa League kur ishte trajner i Sevilla. "Por edhe Premier ka rëndësinë e saj, madje për ne është kompeticioni më i rëndësishëm. Janë 38 ndeshje të vështira, një sezon i gjatë që kërkon përqendrim në çdo ndeshje, kampionat ku do të kemi mundësi të tregojmë vlerat tona. Kam një ekip shumë kompetitiv dhe jam i sigurtë se do të bëjmë një paraqitje të mirë", tha Emery para ndeshjes me Everton.

Publicitet



FORUMI RINOR ISLAM - ИСЛАМСКИ МЛАДИНСКИ ФОРУМ - ISLAMIC YOUTH FORUM
Rr. Krste Misirkov, nr. 57a, lok. 2; 1000 Shkup, Maqedoni; Tel./Fax: +389 2 3233 659 www.fri.org.mk; info@fri.org.mk

Konkurs për çmimin "Shkencëtari i ri i vitit"

Forumi Rinor Islam shpall konkurs për zgjedhjen e shkencëtarit të ri të vitit. Këtë çmim FRI e ndan për punën kërkimore - shkencore të shkencëtarëve të rinj në një fushë të caktuar, për të qenë kështu një motivim për hulumtuesit e rinj në Republikën e Maqedonisë.

Çmimi "Shkencëtari i ri i vitit" ndahet si mirënjohje shoqërore për të arritura të veçanta në çfarëdo lëmi shoqërore apo shkencore.

Çmimi do të ndahet në manifestimin e Vitit të Ri, Hixhri 1440, që organizon Forumi Rinor Islam, në tetor 2018.

Të dhëna të hollësishme mund të gjeni në ueb faqen e FRI-së (www.fri.org.mk) ose shkruani në e-mailin: info@fri.org.mk

Forumi Rinor Islam
Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Në bazë të nenit 126, paragrafi 1, pika 7 e Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015) dhe neni 86 i Statutit të shkollës fillore "Përparimi" - Çegran, lidhur me vendimin e MASH me nr. 08-10803/2 të datës 18.09.2018, bordi i shkollës shpall:

SHPLLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme të nevojshme:

- Të kenë përfunduar arsimin universitar;
- Të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në një institucion arsimor, të verifikuar nga MASH;
- Të përbushin kërkesat për një mësues ose një bashkëpunëtor profesional në arsimin fillor;
- Të kenë dhënë provimin për drejtor;
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- Të mos jetë i dënues për krime që e bëjnë të padenjë për kryerjen e punës edukative.

Kandidatët që do të aplikojnë për konkurs duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimi për konkurrim;
- Dëshmi për arsimin universitar;
- Vërtetim i përvojës së punës në institucion arsimor;
- Konfirmimi se ai nuk është dënues për krime, që e bëjnë atë të padenjë, për kryerjen e punës edukative;
- Dëshmi për provimin e dhënë për drejtorin;
- Vërtetim shtetësie;
- Program pune, për një periudhë 4 vjeçare.

Shpallja publike do të zgjasë tetë (8) ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të bëhet brenda 30 ditëve nga përfundimi i së njëjtës.

Aplikimi me bashkëngjitjet i dorëzohet bordit të shkollës së Shkollës Fillore "Përparimi" - Çegran. Dokumentet e pakompletuara dhe të ofruara jashtë afatit të nuk do të merren në shqyrtim.

BORDI I SHKOLLËS FILLORE PËRPARIMI-ÇEGRAN

Anthony Joshua e ka mposhtur rusin, Alexander Povetkinin, dhe kështu duke i mbrojtur titujt e botës në versionet WBO, WBA, IBF dhe IBO në kategorinë e rëndë të boksit profesionist. Britaniku arriti ta nokautoj rusin në raundin e shtatë, kështu e duke mos pësuar ende humbje



JOSHUA I PAMPOSHTUR

Boksieri britanik Anthony Joshua konfirmohet kampion i botës në peshën e rëndë, pas fitores me "KO" në raundin e shtatë ndaj rusit Alexander Povetkin, duel që u zhvillua në stadiumin "Wembley" të Londrës. Joshua korri suksesin e 22-të në karrierë, duke qëndruar i pamposhtur dhe mbrojtur titujt kampionë në kategoritë IBF, WBO e WBA, ndërsa për rusin kjo ishte humbja e dytë në karrierë, ku numëron edhe 34 fitore. Suksesi nuk ishte aspak i lehtë për boksierin britanik, pavarësisht se e fitoi sfidën me "KO", pasi rivali rus i bëri një start të mirë duelit, duke e dominuar atë në dy raundet e parë, madje duke e vënë në vështirësi Joshua. Vetëm në raundin e katërt britaniku nis të marrë frenat e duelit nën kontroll, duke i shkaktuar një të carë në vetull Povetkin, që nga ai moment nis të lëkundet. Dhe gradualisht, nga raundi në raund Joshua nis të dominojë dhe fitojë terren karshi rivalit. Povetkin

tentoi të rikuperojë, duke qenë më i lëvizshëm në ring, tentoi goditjet nga afër, duke qenë më i shkurtër se Joshua, por pa sukses. Në raundin e shtatë britaniku arriti të hedhë dy herë në tapet rivalin pas disa goditjeve të forta, moment ku Povetkin mezi qëndron në këmbë dhe sfida ndalet. 90 mijë shikuesit në stadium brohorasin dhe përshëndetin suksesin e idhullit të tyre, që sot djersiti shumë për të korrur këtë sukses. Sfidat e radhës e Joshua në prill të 2019-ës. Pas meçit Joshua ka shkuar dhe e ka vizituar boksierin rus Povetkinin, ku dhe ka thënë fjalë të mira për të. "Kjo është e gjitha. Ky është respekti. Ti ke qenë i mirë edhe si amator para se të bëheshe profe-

sionist, ke qenë shumë i qëndrueshëm. Si dhe dua të që të vij në Rusi", i ka thënë Povetkinin Joshua.

JOSHUA ZBULON OBJEKTIVIN E RADHËS: RIVALI IM NUMËR 1 ËSHTË WILDER

Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë, ka konfirmuar pas triumfit ndaj Alexander Povetkin se objektivi i tij i radhës, për duelin e 13 prillit, është amerikan Deontay Wilder. Një përballje që do të sillte unifikimin e titujve kampionë bote në këtë Divizion, pasi Joshua mban trofetë e kategorive IBF, WBA dhe WBO, ndërsa Wilder atë të kategorisë WBC. Joshua, 22 fitore e asnjë humbje në karrierën, mposhti të shtunën me

"KO" në raundin e shtatë rusin Povetkin dhe pas duelit tha: "Ajo që më intereson më shumë tani është sfida e 13 prillit, sërisht këtu para fansave të mi, në "Wembley". Objektivi im kryesor, rivali im numër 1 mbetet Wilder, kaq. Nuk më pëlqen të flas për numrin 2 apo 3. Wilder dhe kaq", u shpreh Joshua. Por Wilder, 40 fitore e asnjë humbje si profesionist, do të mbrojtë titullin kampion më 1 dhjetor ndaj një tjetër boksieri britanik, Tyson Fury dhe një fitore e sfidantit mund të përmbysë hierarkinë. "Ata arritën një marrëveshje dhe ju uroj suksese. Wilder arriti një marrëveshje edhe me mua, unë e firmosa kontratën dhe më pas ai u tërhoq. Nëse nuk do të

duelojë me mua, do ta respektoj vendimin e tij", tha Joshua.

JOSHUA PAS FITORES NDAJ POVETKINIT FITON 22 MILIONË EURO

Anthony Joshua e ka mposhtur rusin, Alexander Povetkinin, dhe kështu duke i mbrojtur titujt e botës në versionet WBO, WBA, IBF dhe IBO në kategorinë e rëndë të boksit profesionist. Britaniku arriti ta nokautoj rusin në raundin e shtatë, kështu e duke mos pësuar ende humbje. 22 ndeshje, 22 fitore, dhe 21 prej tyre i ka fituar me nokaut. Me këtë fitore, Joshua do t'i marrë plot 22 milionë euro, ndërsa Povetkinin do t'i përfitojë 6.5 milionë euro.

Vendimi për Milanin, UEFA pret KAS-in

Milani pret vendimin e UEFA-s, por edhe anasjelltas. Drejtuesit e institucionit më të madh futbolistik në Europë i kanë kërkuar Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dosjen e kuqezinjve dhe motivimet e hedhjes poshtë të dënimit ndaj italianëve. UEFA ka marrë edhe një herë në dorë dosjet me skuadrat që kanë shkelur rregullat e vendosura nga ky institucion për sa u përket financave dhe në mes të shumë dosjeve, është edhe ajo e Milanit. Nuk pritët që UEFA të ndryshojë diçka te Milani, por në fundin e muajit mund të jepet një përgjigje e dytë.

Kjo kërkesë e UEFA-s ka të bëjë me vendimin e ri që duhet të marrë për të sanksionuar "Djalilin", në kuadër të problematikave financiare të shfaqura nga 2014-ta deri në 2018-ën.

Nga zyrat në Nion bëhet e ditur se ekziston vullneti për të mbyllur një herë e mirë çështjen e Milanit, por për të dhënë vendimin përfundimtar, kërkohet njohja me vendimin e KAS-it për të përcaktuar më pas edhe sanksionin e ri për Milanin, që sidoqoftë rrezikon për të mos luajtur në Ligën e Europës e ka lënë pas krahëve.



Ibrahimovic paralajmëron rikthimin në kampionatin suedez

Zlatan Ibrahimovic duket se nuk do të qëndrojë gjatë në kampionatin amerikan MLS. Sulmuesi suedez iu bashkua skuadrës amerikane Los Angeles Galaxy në muajin mars të këtij viti nga Manchester United. Kontrata aktuale e suedezit me gjigantin amerikan skadon në 31 dhjetor të vitit 2020. Por duket se Ibrahimovic do të vazhdojë të luaj futboll edhe pas vitit 2020. 36-vjeçari ka pranuar se i ka ardhur një ofertë nga ish-skuadra e tij Malmo për ta mbyllur karrierën e tij në vendlindje. "Kam marrë një ofertë dhe te Malmo dëshirojnë që unë të kthehem në shtëpi dhe ta përfundojë karrierën", tha Ibrahimovic. Ibra nuk ia ka mbyllur derën pasi po i pëlqen si ide rikthimi në shtëpi dhe të fitojë me Malmon pasi kampionati suedez i mungon. "Nuk e di nëse do të kthehem, nuk ia mbyll dyert kësaj oferte. Është një kampionat që më mungon dhe të shohim", ka thënë suedezi. Ish-sulmuesi i skuadrave të mëdha si Juventus, Barcelona, Milan, Inter, PSG, Ajax e Manchester United ka ironizuar



me ata që nuk besuan në fillim tek ai. "Më e bukura është kur e kujtoj se në fillim të karrierës, thanë të gjithë është një lojtar i mirë por që nuk shënon gola, tani besoj se kanë përgjigjen", tha Ibrahimovic. Sulmuesi suedez javën e kaluar ka arritur numrin magjik të 500 golave në karrierën e tij.



Kosova nuk mund të humbet dy herë

“Disa kilometra katrorë më pak ose disa kilometra më shumë nga kjo anë ose nga ana tjetër e kufirit, është triviale në raport me atë që mund të ndodhë nëse e humbim paqen”, ka vlerësuar kryetari i Partisë Liberale Demokratike (LDP) Çedomir Jovanović duke komentuar debatet aktuale rreth zgjidhjes së problemit Kosovë-Serbi. Jovanović, siç përcjell FoNet, ka thënë se të gjithë duhet ta kenë të qartë se “Kosova nuk mund të humbet dy herë”. “Për shkak të politikës së gabuar ndaj popullit shqiptar, kemi hyrë në luftë nga e cila kemi dalë me kapitullim”, ka përfunduar Jovanović.

Nga tetori SHBA përfshihet në dialogun Kosovë-Serbi

Përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës së shpejt do të përfshihen më aktivisht në ndërmjetësimin në mes të Beogradit e Prishtinës në negociatat për marrëveshje. Siç shkruan gazeta e Beogradit “Danas”, kjo përfshirje do të zhvillohet përmes “shuttle diplomacisë” në bisedat me zyrtarët më të lartë në kryeqytetet e Serbisë e të Kosovës. Siç kanë thënë burime të kësaj gazete, SHBA-ja po pret përfundimin e referendumit në Maqedoni të caktuar për 30 shtator dhe pastaj do t’i shtojë aktivitetet. “Qëllimi i SHBA-së është që me zhvillimin e shuttle diplomacisë t’i afrojë qëndrimet e Beogradit e të Prishtinës me synimin që të arrihet teksti kornizë i marrëveshjes për Kosovën në mënyrë që dokumenti final të nënshkruhet në pranverën e vitit të ardhshëm. Pritet që deri më atëherë kryetari serb Vuçiqi dhe ai kosovar Thaçi do t’ia dalin ta arrijnë përkrahjen e qeverive dhe të parlamenteve të veta dhe që në opinionin e të dy vendeve të krijohet klima për përkrahjen e korigjimit të kufijve në marrëveshjen finale”, kanë thënë diplomatët të cilët “Danas” nuk i identifikon.



Përplasjet me deklarata të krerëve të institucioneve më të larta të Kosovës, presidentit Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ramush Haradinaj, shpërfaqin skajshëm mungesën e një konsensusi të spektrit politik institucional, lidhur me qasjen ndaj dialogut me Serbinë në Bruksel, por edhe rivalitetet e moçme politike, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në vend

Së fundmi Haradinaj, të mërkurën, në një emision të televizionit Klan të Shqipërisë, duke kundërshtuar idenë e ndryshimit të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilën presidenti Thaçi e quan “korigjim të kufirit”, ka thënë se “kufijtë që i kanë vendosur çizmet (ushtarake) vetëm çizmet i garantojnë. Nuk lejoj të preken kufijtë tanë”, ka thënë Haradinaj. Duke iu referuar kësaj deklaratë, presidenti Thaçi ka thënë të enjten se “ata që po flasin për luftëra, nuk jam duke i penguar, kush të ketë qejf le ta nisë ku të dojë” dhe se “luftërat nuk zhvillohen në emisione televizive por në istikame”.

Arton Demhasaj, drejtor i organizatës joqeveritare “Çohu”, duke folur për Radion Evropë e Lirë, i vlerëson të dëmshme përplasjet përmes deklaratave të presidentit Thaçi dhe kryeministrit Haradinaj, të cilat sipas tij, përveç kundërshtimeve parimore, përmbajnë edhe një dozë të madhe të rivaliteteve

Vetëvendosje edhe për boshnjakët e Sanxhakut

Bartësi i listës Samoopredeljenje (Vetëvendosje) për zgjedhjet e Këshillit Kombëtar Boshnjak (BNV) të Sanxhakut, Sulejman Uglanin, ka deklaruar se boshnjakët nuk janë minoritetet. Ai ka shtuar se boshnjakët janë popull që do ta respektojë Serbinë aq sa Kushtetuta e këtij vendi do t’i respektojë boshnjakët. “Nuk e pranojmë statusin e qytetarëve të rendit të dytë. Duam shtetin e të drejtës të bazuar në sun-

PËRPLASJA QË PO DËMTON KOSOVËN

politike. “Padyshim që janë rivalitetet politike, siç kanë qenë edhe para se të ekzistojë kjo qeveri që sot e kemi. Kemi, në njërin anë, presidentin i cili kërkon korigjim të kufirit dhe në anën tjetër, kemi kryeministrin, i cili në asnjë anë nuk lejon që të preket vija kufitare që ka qenë dhe që është e sqaruar edhe me Dokumentin e Ahtisaarit. Qeveria ka emëruar edhe një grup të caktuar për dialog që, në njëfarë mënyre, t’ia pamundësojë presidentit diskutimin e çështjes së kufijve. Nëse udhëheqësit kryesorë të institucioneve, presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, nuk pajtohen për mënyrën se si duhet të negociohet në dialogun me Serbinë dhe cilat duhet të jenë ato ‘vijat e kuqe’ për çka nuk duhet të diskutohet, atëherë unë konsideroj që ky është një problem shumë i madh”, theksoi Demhasaj.

Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë për Radion Evropë e Lirë se përplasjet verbale ndërmjet krerëve institucionale, tregojnë mungesën e koordinimit ndërinstitucional dhe se ndërmjet tyre nuk ka shkëmbim informacionesh se për çka është duke u diskutuar në procesin e dialogut.

Kush do t’i prijë dialogut? “Po shihet që po udhëhiqet prej presidentit Thaçi. Qeveria, me anë të një vendimi që ka marrë para disa muajsh, i ka dhënë aprovimin dhe e ka hequr mandatin prej vetes, duke e bartur atë te presidenti Thaçi për ta menaxhuar këtë proces. Ka qenë vetë kryeministri Haradinaj që ka thënë ‘unë nuk kam kohë që të merrem me këtë proces’. Në fakt, po reflektohet që mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve është problem, pasi që po kemi mesazhe të ndryshme nga krerët institucionale dhe po shihet që reflekton më pas në mungesën e një qëndrimi unik shtetëror të Kosovës”, tha Krasniqi.

Mungesa e koordinimit të krerëve institucionale, sipas njohësve të zhvillimeve politike, do t’i hapë mjaft probleme Kosovës në pozicionimin saj në dialogun e Brukselit, si dhe për qasjen ndaj këtij dialogu. Demhasaj thotë kur këtyre mosmarrëveshjeve u shtohet edhe mospajtimi i opozitës për qasjen ndaj dialogut, kjo e vë Kosovën në pozitë mjaft të pafavorshme në këtë proces.

“Kur presidenti Thaçi shkon dhe negocion në Bruksel për një temë të tillë (‘korigjim të kufirit’),

atëherë i duhet të llogarisë se për këtë nuk e ka përkrahjen, fillimisht të institucioneve të Kosovës, e pastaj partive tjera politike. Ai diskutim, pastaj, mund të jetë vetëm në emrin e tij personal ose vetëm duke u bazuar në institucionin e Presidentit dhe jo në të institucioneve tjera. Kështu që, është një pozitë shumë e pafavorshme, e cila e vendos Kosovën po ashtu në pozitë të pafavorshme dhe e forcon pozitën e Serbisë, të cilën edhe ashtu e ka të forcuar sot”, u shpreh Demhasaj. Mendim të ngjashëm ka edhe Krasniqi. “Një përçarje e tillë apo moskëzimi i një qasje unike e shtetit të Kosovës në këtë proces, patjetër që mund ta dëmtojë Kosovën dhe qëndrimin apo pozicionin e saj në këtë dialog”, theksoi Krasniqi. Sidoqoftë, Krasniqi ka thënë se pavarësisht faktit që Kosova dhe Serbia janë pjesë e negociatave të lehtësuara nga Bashkimi Evropian, në këtë proces janë të përfshirë edhe faktorë tjerë të fuqishëm ndërkombëtarë. Përcaktimi i qëndrimit të këtyre të fundit karshi pozicioneve, të cilat janë duke u artikulluar në Prishtinë dhe Beograd, sipas saj, do të ndikojnë edhe në politikën e brendshme të Kosovës. (REL)



"FORT TRUMP" NË POLONI!

Askund tjetër në Evropë nuk gëzojnë SHBA një simpati si në Poloni. Ka të bëjë me historinë, me Rusinë dhe me një porcion mosbesimi përballë NATO-s. Polonia kërkon ushtarë të SHBA - është e gatshme të paguajë për këtë



mbrohen nga Amerika e fortë, por që i lënë vetes kohë kur vjen puna për të përcjellë paratë.

SI NDIHET POLONIA DHE NJË PLAN

Polonia, në skajin periferik lindor të Evropës, de facto një pararojë e BE përballë Rusisë së fuqishme, ka një nevojë të theksuar për siguri, të kushtëzuar nga historia. Tri ndarje në histori dhe një jetë prej dekadash vasali nën yllin e kuq e mbajnë vendin në epokën e Putinit në qëndrim të vazhdueshëm gatitu. Thujse me entuziazëm e pritën polakët mbërritjen e 3500 ushtarëve amerikanë në Zagan të Silezisë, vetëm 100 kilometra larg kufirit me Gjermaninë. Bashkë me ta qenë 87 tanke dhe 400 xhipa "Humvee". Një kontingjent rotacioni në kuadër të aksionit të NATO-s, "Atlantic Resolve", që zëvendësohet çdo nëntë muaj nga ushtarë të shteteve të tjera të NATO-s.

Kjo nuk është e mjaftueshme për ndjenjën e sigurisë së polakëve. Qeveria nacionalkonservatore PiS në Varshavë kërkon prani të përhershme dhe para së gjithash ushtarë amerikanë. Këtë qeveria

polake ka kohë që e kërkon në traditën më të mirë lobiste. Një dokument me titullin "Propozim për një prani të përhershme të SHBA në Poloni" po qarkullon te nëpunësit e qeverisë, të Kongresit dhe në qendrat kërkimore në SHBA. Konkretisht bëhet fjalë për një divizion të plotë të blinduar.

PËRMBAJTJE NË BERLIN

Në Berlin këmbënguljen polake për praninë e SHBA e ndjekin të distancuar deri në kritikë. Në pikëpamjen e politikës së sigurisë, "një prani e përhershme e SHBA në Poloni do t'i shtonte edhe më tej tensionet midis NATO-s dhe Rusisë", i thotë DW eksperti për politikën e jashtme i socialdemokratëve (SPD), Rolf Mützenich.

Ngjashëm e sheh këtë ish-oficeri i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë gjermane dhe deputet i CDU-së Roderich Kiesewetter. Vërtet që takimi i nivelit të lartë të NATO-s në korrik përforcoi që do të rritet aftësia mbrojtëse dhe e reagimit, por "stacionimi i përhershëm në Poloni...sipas të gjitha gjasave do të ishte në kundërshtim me Aktin Themelor Nato-Rusi", i thotë ai DW. Rusia reagon

deri tani e përmbajtur ndaj planeve të "Fort Trumpit" të Polonisë. Por parimisht NATO-ja vështrohet në Moskë si kërcënim.

SHBA DUAN PARTNERË QË PAGUAJNË, POLONIA ËSHTË E GATSHME

Por planet nuk janë fakte. "Nuk besoj se ministria amerikane e Mbrojtjes është e entuziazmuar", thotë ekspertja ushtarake e Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS), Heather Conley. Edhe nëse Trumpi i vlerëson polakët si "shpirtin e Evropës", dhe të dojë ta plotësojë dëshirën e Varshavës, kongresi i SHBA do të ketë mundësi të thotë një fjalë. Edhe Pentagoni do të "shtrojë disa pyetje shumë të rëndësishme", thotë Conley. Tema ushtarë të SHBA në kufirin lindor të Polonisë nuk përshtatet si duhet as me prioritetet politike të Trumpit. Në Aleancën Mbrojtëse Atlantikore ai synon ta zvogëlojë rolin e SHBA dhe të angazhojë më shumë partnerë të tjerë. Me marrëveshjen me Poloninë, SHBA do të ishin pa pritur edhe më fort përgjegjëse se deri tani për sigurinë në kufirin lindor të NATO-s. (DW)

Alkooli vret tre milionë njerëz në vit

Përdorimi i dëmshëm i alkoolit ka vrarë mbi tre milionë persona më 2016, duke bërë që një në 20 vdekje në botë t'i atribuohet pirjes së alkoolit, thuhet në studimin e publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Raporti i titulluar "Statusi Botëror mbi Alkoolin dhe Shëndetësinë 2018", i publikuar nga Organizata e OKB-së, tha gjithashtu se shkallja e konsumimit të alkoolit në vendet si Rusia, Moldavia, Bjellorusia kanë shënuar rënie në dekadën e kaluar. Raporti po ashtu tha se në nivel botëror, mbi tre e katërta e vdekjeve nga alkooli kanë qenë meshkuj. "Shumë njerëz, familjet e tyre dhe komunitetet kanë vuajtur nga pasojat e përdorimit të dëmshëm të alkoolit përmes dhunës, lëndimeve, problemeve të shëndetit mendor dhe sëmundjeve si kanceri dhe sulmet", tha doktor Tedros Adhanom Ghebreyesus, drejtor i përgjithshëm i OBSH-së. Sa i përket vdekjeve, 28 për qind janë shkaktuar nga lëndimet, siç janë aksidentet e trafikut; 21 për qind nga çrregullimet e tretjes; 19 për qind nga sëmundjet kardiovaskulare; dhe vdekjet e tjera nga sëmundje infektive, kanceret, çrregullimet mendore dhe sëmundje të tjera shëndetësore, thuhet në raport. "Në nivel botëror, vlerësohet se 237 milionë burra dhe 46 milionë gra vuajnë nga sëmundjet që lidhen me konsumimin e alkoolit, me përhapjen më të lartë në kontinentin evropian të konsumuesve të alkoolit", thuhet në raport. Raporti vlerëson se 2.3 miliardë njerëz konsumojnë alkool, me më shumë se gjysmën e popullsisë në tri rajone - Amerikë, Evropë dhe Paqësorin Perëndimor.

Irlanda mund ta njohë shtetin e Palestinës

Ministri i Jashtëm i Irlandës, Simon Coveney tha se nëse nuk do të ketë progres në negociatat për paqe në mes të Palestinës dhe Izraelit atëherë vendi i tij do ta njohë shtetin e Palestinës

Ministri i Punëve të Jashtme të Irlandës, Simon Coveney deklaroi se në qoftë se nuk do të ketë progres në negociatat për paqe në mes të Palestinës dhe Izraelit atëherë vendi i tij do ta njohë shtetin e Palestinës. Coveney në një konferencë të përbashkët për media me homologun e tij palestinez, Riyad el-Maliki, i cili ndodhet në vizitë zyrtare në Dublin tha se "Kemi bërë një zgjidhje në drejtim të mosnjohjes vetëm tani për

tani' të shtetit të Palestinës por nëse vazhdon kjo pashpresë në funksionimin e dialogut atëherë ne do të detyrohemi që të rishikojmë këtë zgjidhje për shkak të arsyeve shumë të hapura". Ai nënvizoi se në qoftë se Irlanda njeh shtetin e Palestinës, atëherë kjo mund të ndiqet edhe nga shtetet tjera të Evropës. Coveney tha se shteti i tij mendon të ndër-marrë një iniciativë për rifillimin e procesit të paqes duke organizuar

një takim ku do t'i bashkojë përfaqësuesit palestinezë dhe disa vende arabe e evropiane. Duke e vlerësuar si "gabim" vendimin e presidentit të SHBA-ve Donald Trump për ndërprerjen e ndihmave të ofruara për Palestinën, nëpërmjet Kombeve të Bashkuara, Coveney theksoi se Irlanda si përgjigje ndaj kësaj ndihmën në vlerë prej 4,5 milionë euro do ta rrisë në 7 milionë euro. Në muajin korrik Senati i Irlandës miratoi



projektligjin i cili ndalon importin dhe tregtinë e mallrave të prodhuara në territoret e pushuara. Projektligji do të shndërron në ligj në qoftë se miratohet

nga Dhoma e Ulët e Parlamentit. Nëse shndërrohet në ligj, Irlanda do të bëhet shteti i parë i BE-së, i cili sjellë një ndalesë të tillë ndaj vendbanimeve izraelite.



Nga Qerim LITA

(vijon nga numri i kaluar)

Hapja e shkollave të para kombëtare shqiptare, në historiografinë më të re shqiptare konsiderohet si Rilindja e dytë për shqiptarët e këtyre trojeve. S'do mend se për këtë meritë të madhe patën mësuesit shqiptarë, të cilët me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, përkatësisht ministrit Koliqi, që të kyçen në procesin e hapjes së shkollave në viset e liruara, me kënaqësi pranuan të vijnë në këto vise, duke i lënë të gjitha privilegjet që i gëzonin atje, vetëm e vetëm që t'ju dalin në ndihmë vëllezërve të tyre, të cilët posa ishin çliruar nga robëria tridhjetëvjeçare serbe. Shumë mësues me prejardhje nga Dibra e Madhe, të cilët për shkaqe politike ishin detyruar të vendoseshin në Tiranë e në qendra tjera të shtetit shqiptar, i shkruanin Ministrisë së Arsimit që t'ua mundësoj kthimin e tyre në vendlindje, me qëllim që të japin kontributin e tyre në ngritjen e vetëdijes kombëtare në ato toka të çliruara shqiptare. Me këtë rast e pamë të arsyeshme ta veçojmë letrën e doajenit të arsimit shqiptar të Dibrës, Remzi Pustina, i cili asaj kohe punonte si mësues në ShF. Në Vlorë:

"...Me rastin gazmuer të çlirimit qytetit t'im...., e mbas 2 vjet shërbimi në qytetin e Vlorës, lutem përunjësisht që në vitin e ardhshëm shkolluër 41-42 të transferohem në qytetin e Dibrës së Madhe ku kam shtëpinë e pasunin e trashëgueme prej prindërve të mi, gja e cilla, jo vetëm do të më ndihmonte në pikëpamjen ekonomike, porë, do të më jepte kurajon për me punuë me vullnet të pa thyeshëm për dritën e Arsimit Kombëtar për të cilën ky vend vuën edhe sod...". Kjo kërkesë e Pustinës u mbështet edhe nga kryetari i Misionit të Jashtëzakonshëm Shkollor për Prefekturën e Dibrës. Prof. Fadil Repishti, i cili më 25 gusht 1941 i shkruante Ministrisë së Arsimit Kombëtar me sa vijon:

"Gjatë kohës së Misjonit Shkollor në Qarkun e Dibrës mësuesi Z. Remzi Pustina vullnetarisht ka shërbye në organizimin e rinisë, dhe ka tregue një aktivitet të gjallë, e do t'ishte shumë i përshtatshëm transferimi i tij në këtë qendër".

Veprimtaria e mësuesve shqiptarë në Tokat e Liruara, përveç punës edukativo-arsimore, u dallua edhe në vetëdijesimin nacional të popullsisë shqiptare, duke krijuar një plejadë të kuadrin rinor, i cili pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, përkundër dhunës dhe terrorit komunist jugosllav arriti ta mbajë gjallë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, të cilës i printe Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare.

"Inteligenca që erdhi gjatë

DIBRA E MADHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (3)

KUR ENVER HOXHA SHQIPTARËT E MAQEDONISË I QUANTE "PAKICË"

Historiografia komuniste, si ajo shqiptare, ashtu edhe ajo jugosllave, Dibrën si tërësi, me pa të drejtë dhe në mënyrë tendencioze e paraqesin si "vatër" të lëvizjes komuniste. Është fakt i pamohueshëm se komunizmi jugosllav, gjatë LDB-së, hasi në mbështetje te një shtresë e vogël e popullsisë shqiptare të kësaj krahine, e cila ishte rrjedhojë e propagandës së fuqishme të komunistëve jugosllav, në krye me Svetozar Vukmanoviq - Tempo

kohës së okupacionit, - thuhet në një dokument të UDB-së jugosllave - ishte drejtuesja e më shumë ngjarjeve irredentiste dhe shoviniste. Nga këta mësues u krijua Organizata Nacional Demokratike Shqiptare. Mendimet e veta shoviniste dhe irredentiste, mësuesit i përcillnin sistematikisht dhe me shkathhtësi të shtresat. Vetë detyra e NDSH-së ishte: restaurimi i së vjetrës me ndihmën e perëndimit për krijimin e Shqipërisë së Madhe...".

Historiografia komuniste, si ajo shqiptare, ashtu edhe ajo jugosllave, Dibrën si tërësi, me pa të drejtë dhe në mënyrë tendencioze e paraqesin si "vatër" të lëvizjes komuniste. Është fakt i pamohueshëm se komunizmi jugosllav, gjatë LDB-së, hasi në mbështetje te një shtresë e vogël e popullsisë shqiptare të kësaj krahine, e cila ishte rrjedhojë e propagandës së fuqishme të komunistëve jugosllav, në krye me Svetozar Vukmanoviq - Tempo, i cili gjatë vitit 1943 për disa muaj qëndroi në hapësirat shqiptare në cilësinë e të deleguarit të Lidhjes komuniste të Jugosllavisë (LKJ-së). Gjatë asaj periudhe kohore, arriti ta bindë kreun e PKSH-së, për arritjen e një marrëveshje politike dhe ushtarake, e cila u nënshkrua më 25 qershor 1943 në Korçë nga ana e tij si përfaqësues i PKJ-së dhe Koçi Xoxes si përfaqësues e PKSH-së. Marrëveshja politike, do të realizohej "me ndihmën e ndërsjellët" për t'u ngritë siç thuhet në dokument: "pakica nacionale në luftë kundër okupatorit, shumica e së cilës sot qëndron në shërbim të okupatorit; në radhë të parë është pakica shqiptare e Maqedonisë...". Me kërkesë të Tempos, Enver Hoxha, lëshoi një qarkore, deri te komunistët shqiptarë, që punonin në Trevat Lindore, që ta "rekomandojnë politikën komuniste" dhe në këtë drejtim, ata në mesin e popullsisë vendore shqiptare: "ta propagandojnë vëllazërim bashkimin mes popullit shqiptar me ato jugosllav...".

Në anën tjetër, marrëveshja ushtarake, obligonte FNÇSH-në "të dërgojë çeta shqiptare, të cilat do të jenë nën komandën e Haxhi Lleshit në Zonën operative I të Maqedonisë...". Çetave shqiptare, sipas marrëveshjes, do t'u jepej detyrë speciale

të propagandojnë në rajonet shqiptare me këto parulla:

1. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet që bashkërisht me maqedonasit të luftojë kundër okupatorit dhe kundër të gjithë bashkëpunëtorëve të saj.

2. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet të ndërpresë luftën vëllavrasëse, të cilën e inspiron okupatori dhe shërbëtorët e tij.

3. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet që bashkërisht me popullin maqedonas, të krijojnë UNÇ-në e përbashkët nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm të LNÇ-së maqedonase.

4. Vetëm në këtë rrugë pakica shqiptare, bashkërisht me popullin maqedonas, do të marrë garancinë që me të vërtetë lirisht do të vendosë për fatin e vet në të drejtën e vetëvendosjes...!".

Marrëveshja për bashkëpunim politik dhe ushtarak që u arrit mes Tempos dhe udhëheqësit e PKSH-së, fillimisht do të kontestohet nga Haxhi Lleshi, i cili në një letër dërguar SHP të Frontit Nacionalçlirimtar, shkruante:

"Në një dokument që na tregoi shoku Tempo, të firmosur nga shoku Koçi Xoxe, thuhet se disa krahina megjithëse shumica janë shqiptare, si për shembull Dibra, mvaren nga Shtabi Maqedonas për organizimin etj. (ky dokument ka edhe firmën e Tempos dhe të një përfaqësuesi grek)...Nëse kjo krahinë, do të mvaret prej Shqipërisë mejtojmë, natyrisht, dhe të mirën e popullit maqedonas simbas parimit t'onë (K). E mvarmja e Dibrës nga Shtabi Maqedonas bën përshtypje të keqe edhe në krahinat e tjera si, për shembull, në Kërçovë, në Gostivar, në Strugë e tjera, ndërsa, e kundërta, ban përshtypjen ma të mirë meqë neve jemi të njohur në ato anë dhe i mbyllet rruga njëherë e përgjithnjë (deri sa të forcohem i ne) çdo rrugë reacionare...".

Nga reagimi i Haxhi Lleshit, shihet qartë se kishin nisur përplasja dhe mospajtime edhe në shtabin e tij, prandaj ai kërkonte që përkohësisht, siç thekson në letër "deri sa të forcohem i", krahina e Dibrës të jetë e varur prej Shtabit të Përgjithshëm të LNÇSH-së.

Nëse shikohet përmbajtja e marrëveshjes në të cilën Partia Komuniste Shqiptare obligohej që, krahas propagandimit politik të dërgojë edhe çeta ushtarake, të cilat do të vepronin sipas direktivave të Shtabit Kryesor të LNÇ-së për Maqedoni, nuk mund të kuptohet ndryshe veçse futja e vëllavrasjes në këto treva. Koha kur është nënshkruar kjo, përputhet me bisedimet e Mukjes, andaj nga kjo del se Fronti Popullor, Mukjen nuk e konsideronte si një projekt me karakter afatgjatë mbarëkombëtar, por si një reklamë para opinionit shqiptar, që me kalimin e kohës ajo të hidhet poshtë. Ndikimi jugosllav ishte tepër i madh, andaj Tempo, Popoviçi dhe Mugosha nuk patën vështirësi t'i imponojnë projekte antishqiptare krahut komunist shqiptar.

Ndërkohë, Tempo, me ndihmën e H. Lleshit dhe Mehmet Hoxhës (në atë kohë prefekt i Dibrës), përvetësoi komandantin e xhandarmërisë së Nënprefekturës së Kërçovës, Hamdi Demën, i cili kah mbarimi i korrikut u arratis në mal së bashku me 42 xhandar e disa nëpunës të asaj nënprefekturë. Atij iu bashkangjit edhe prefekti M. Hoxha, i cili njihej si njëri ndër më besnikët e politikës komuniste jugosllave.

Mirëpo, sado që fryma komuniste gjeti strehë në këtë qytet me traditë të lashtë jo vetëm ushtarake, por edhe kulturore e arsimore, e njëjta ishte tepër minore përballë frymës properëndimore, përkatësisht, asaj anglo-amerikane, në ballë të cilës krahas mësuesve shqiptar, për të cilët u bë fjalë më lartë, qëndronin edhe intelektual të fushave tjera, personalitete të shquara të dijes e të pushkës, siç ishin: Shemsi Hatipi, Qeram Zllatku, Munir Shehu, Uke Cami, Osman Cami, Edip Tërshana, Medat Tërshana, Esat Mezechiu, Ibrahim Tërshana, Fiqiri Dine, Fik e Ali Maliqi e shumë personalitete tjera. Historiani i mirënjohur amerikan, Bernd Fischer, në librin e tij me titull: "Shqipëria 1943-1945 - një vështrim përmes dokumenteve perëndimore", e publikon në tërësi Raportin e Misionit të Departamentit të Shtetit në Tiranë, që më këtë rast po i referohemi pjesës ku bëhet fjalë për pozitën ndërkombëtare të

Shqipërisë, ku ndër të tjerave thuhet se shqiptarët janë më pro-amerikan se në çdo vend të Ballkanit:

"...burimi i rëndësishëm i kësaj ndjenje pro-amerikane - thuhet në raport - është rezultat i aktiviteteve të shkollës teknike shqiptare që u mbajt për dymbëdhjetë vjet në Shqipëri nga Kryqi i Kuq Amerikan dhe qeveria shqiptare, nën drejtimin e z. Harri T. Fulc (Hyrry T. Fultz). Gjatë ekzistencës së kësaj shkolle, ajo u ndoq nga më shumë se 5.000 shqiptarë, kurse gati njëmijë prej tyre u diplomuan...Ka edhe një grup më të vogël pro-amerikan, që përbëhet nga të diplomuar të shkollës bujqësore, e cila funksionoi dhe u mbajt për disa vjet në Kavajë nga Fondacioni i Lindjes së Afërme dhe së fundi, ka edhe një grup më të vogël zyrtarësh apo ish-zyrtarësh që punonin në Fondacionin Rokfeler në veprimtaritë e shëndetit publik dhe kontrollit malarial...".

Iu referova këtij dokumenti, për arsye se një numër i konsiderueshëm i nxënësve të kësaj shkolle ishin me prejardhje nga Dibra e Madhe, të cilët sikurse edhe mësuesit për të cilët u bë fjalë më lartë, edhe ata posa Dibra e Madhe iu bashkua shtetit shqiptar, u kthyen në qytetin e tyre të lindjes, për të dhënë kontributin e tyre kombëtar. Në mesin e tyre duhet veçuar veprimtarin dhe atdhetarin e shquar shqiptar, Osman Cami, i cili pas mbarimit të LDB-së, së bashku me dr. Qeram Zllatkun, do të jenë themeluesit dhe udhëheqësit kryesor të Komitetit të NDSH-së për Qarkun e Dibrës, një organizatë antikomuniste, e cila qe themeluar në janar të vitit 1945 në Shkup, nga intelektualët e atëherëshëm shqiptar: Azem Marana, Hasan Bilalli dhe Mahmut Dumani.

Pikërisht nga kjo plejadë intelektuale e atdhetare shqiptare të Dibrës, në verën e vitit 1943 u iniciua dhe u themelua Komiteti Kombëtar i njohur me emrin "Bashkimi Dibran".

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shqiptare, me 1 gusht 1943 njoftonte Ministrin e Punëve të Brendshme me sa vijon: "Kohët e fundit, ashtu krijue një bashkim interesash në mes të Cen Elezit, Muharrem Bajraktarit, Myftar Kaloshit, Ali Maliqit e të Këshilltarit Epruer Fiqiri Dine, me qëllim që me çue mbrenda një kohe të shkurtë popullsinë kundër gjendjes së tashme...Ata janë marrë vesh që kjo aleancë të shtrihet edhe në qendrat e tjera, për çka dy të parët duhet të mësyjnë Prizrenin tre të tjerët Dibrën e Peshkopinë...".

(vijon në numrin e ardhshëm)

SI U PARANDALUA KOMPLOTI I KGB-SË

SPIUNI ANGLEZ QË SHPËTOI GORBAÇOVIN

Pas gati tridhjetë vjetësh, 007 i Madhërisë së Tij vendosi të zbulojë historinë e tij. Ai e bëri atë në një libër "Pilgrim Spy", i sapobotuar në Angli: një libër ku tregohen historitë e ndjekjeve në tavanë, hetimet terroriste, një spiune gjigante gjermano-lindore, ikjet nëpër pyje. Dhe nga një kundërshtar, një zyrtar misterioz i KGB-së: një Vladimir Putin më i madh. Libri është nënshkruar nga Tom Shore: por ky nuk është emri i tij i vërtetë, identiteti i tij ende nuk është mbrojtur

Mikhail Gorbaçovi duhej të vdiste. Udhëheqësi sovjetik, i cili kishte filluar reformat në bllokun komunist, duhej të binte nën goditjet e vrasësve në mëngjesin e 7 tetorit 1989, gjatë fjalimit publik në Berlinin lindor para udhëheqësve të Gjermanisë së atëhershme Lindore. Për të armatosur duart e vrasësve-anëtarët e Raf, grupi terrorist gjerman i krahut të majtë - ishin shtresat e vështira brenda udhëheqjes së BRSS, në kundërshtim me hapjet e Gorbaçovit: por një agjent i SAS-it, forcat speciale legjendare britanike, të infiltruar në Perden e Hekurt, arriti të nxjerrë në pah komplotin.

Dhe ndryshoi rrjedhën e historisë. Pas gati tridhjetë vjetësh, 007 i Madhërisë së Tij vendosi të zbulojë historinë e tij. Ai e bëri atë në një libër "Pilgrim Spy", i sapobotuar në Angli: një libër ku tregohen historitë e ndjekjeve në tavanë, hetimet terroriste, një spiune gjigante gjermano-lindore, ikjet nëpër pyje. Dhe nga një kundërshtar, një zyrtar misterioz i KGB-së: një Vladimir Putin më i madh. Libri është nënshkruar nga Tom Shore: por ky nuk është emri i tij i vërtetë, identiteti i tij ende nuk është mbrojtur. Nuk mund të fotografohet ose të filmohet, por mediat italiane kanë cuar njerëz për ta takuar në Londër për të dëgjuar nga zëri i tij versionin e këtyre fakteve.

Pse keni vendosur të dilni vetëm tani?

"Pas 30 vjetësh, shumica e njerëzve të përfshirë kanë vdekur ose janë pensionuar për një kohë të gjatë. Është një histori që duhet thënë: nëse nuk e bëj tani, ajo kurrë

nuk do të dihet, do të humbasë. Unë nuk e imagjinoj njerëzit e tjerë të përfshirë duke u thënë versionin e tyre. Ishte një periudhë traumatike për mua: dhe kujtesa ende djeg".

Megjithatë, duket një histori e pabesueshme komploti për vrasjen e Gorbaçovit...?

"Gjatë viteve të perestrojka Gorbaçovi ishte objektivi i disa përpjekjeve për ta vrarë atë. Të vështirët e partisë dhe KGB-së nuk donin ndryshimin: dhe kohët e fundit deklarimet e CIA-s tregojnë përpjekjet e ndryshme për ta eliminuar atë. Tashmë më 6 mars 1989, ministri i tij i mbrojtjes, Dimitër Yazov, u përpoq ta nxjerrë atë nga një takim i



Byrosë Politike. Arsyeja që më në fund u kthyen në RAF është se kjo do të kishte garantuar anonimitet".

Si e keni ndaluar komplotin?

"U ballafaqova me dy burra të armatosur - atëherë unë nuk e dija se ishin anëtarë të Raf - dhe qëllimet e tyre ishin të dukshme. Unë arrita ta përmbys situatën dhe t'i çarmatosja: i vura në gjunjë dhe i mora në pyetje me një armë në kokë.

Dhe në këto situata nëntë herë nga dhjetë ju thoni të vërtetën. Ata më treguan se çfarë po ndodhte, pse ata ishin atje dhe fakti që kjo komplot ishte në proces. Të dy njerëzit që kam intervistuar nuk ishin në dijeni të detajeve, i vetmi që i njihje ato ishte një lloj që kisha takuar tashmë, në librin që unë e quaj Metzger. Në krye ishte një grup i vogël që kishte gjetur se kush mund ta ekzekutonte planin: kështu që vendosa të prisja kokën e gjarpurit. Duke bërë këtë, ndoshta do të kisha ndaluar komplotin. Por në mëngjesin kur duhej të ndodhte, unë pashë Gorbaçovin në podium në Berlin gjatë fjalimit të tij të famshëm: Unë prisja ende që të ndodh-

te, nuk isha i sigurt se kisha ndaluar gjithçka. Ata ishin tradhtuar nga obsesioni i tyre me siguri: vetëm ai njeri, Metzger, në kohën e duhur do të kishte kontaktuar njerëzit në Berlin dhe duke marrë sinjalin. Dhe kjo është ajo që i ka ndaluar ata".


Ju keni ndryshuar rrjedhën e historisë.

"Nuk po them këtë, por nëse sulmi do të kishte ndodhur, sovjetikët do t'i dërgonin tanket në Gjermaninë Lindore dhe kjo do të ishte fundi i të gjitha gjërave. Unë nuk mendoj se Muri i Berlinit do të kishte rënë".

Ju gjithashtu thoni se keni paguar një çmim personal?

"Unë kurrë nuk kam bërë miq me lehtësi, por ky episod përforcoi gjithë këtë: njerëzit që mendova ishin miqtë e mi ishin terroristë që mund të më vrisnin. Por kjo ishte mënyra me të cilën njerëzit që besoja më tradhtuan mua më së shumti".

Nëse të gjithë ju kanë tradhtuar, ku është besnikëria juaj?



"Besnikëria ime ka qenë gjithmonë në Britani. Disa mund të mendojnë se është jashtë modës, por unë kam qenë një ushtar britanik. Agjentët e forcave speciale duhet të besojnë se ajo që bëjnë ata është e drejtë dhe për një të mirë më të madhe. Duhet gjithashtu të besoni se komandantët tuaj punojnë për të njëjtin qëllim. Por gjatë kësaj çështjeje unë zbulova se jo gjithmonë ishte kështu. Por kjo nuk e ndaloi besnikërinë time ndaj miqve të mi, shokëve të mi dhe vendit tim".



II. Kushtet dhe kriteret për aplikim, regjistrim dhe seleksionim

Aplikimi, seleksionimi, rangimi dhe regjistrimi i kandidatëve në kategoritë e caktuara në e tretë do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Konkursin për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Tetovës të shpallur më 20.06.2018 në gazetën "Lajm", "Koha" dhe "Nova Makedonija" si dhe në ueb faqen www.unite.edu.mk

Kandidatët të cilët arrijnë më pak se 40 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve, do të pranohen vetëm nëse mbeten vende të lira në kategoritë e caktuara me konkurs, për të cilët do të vendos komisioni qendror.

Në afatin e dytë për regjistrim, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore nuk mund të aplikojnë kandidatët shtetas të huaj, për shkak se janë plotësuar të gjitha vendet e lira për këtë kategori të studentëve.

III. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi

REALIZIMI I KONKURSI PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2018/19	Afati III
Aplikimi (paraqitja e kandidatëve/dorëzimi i dokumenteve)	24-25 shtator
Kontrolli i njohurive dhe aftësive (për programet dhe kategoritë e caktuara)	26 shtator
Shpallja e rezultateve preliminare dhe afati i ankesave	27 shtator
Shpallja e vendimit për praninë të kandidatëve	28 shtator
Regjistrimi i kandidatëve	1-3 tetor 2018

IV. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim

- Kandidatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: www.unite.edu.mk (Regjistrimet 2018/19) me të dhënat përkatëse dhe sipas udhëzimeve që kërkohen;
- Fletëaplikim (merret në administratë gjatë dorëzimit të dokumenteve);
- Dëftesa origjinale nga shkollimi i mesëm;
- Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme;
- Certifikatë nga libri amzë i të lindurve;
- Certifikatë për nënshtetësi;
- Vërtetim për pagesat e:

- 1050 denarë në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.
- 600 denarë mjete plotësuese për secilin lëndë të cilës kandidatët do të nënshtrohen për provim pranues të theksuar në Listën shtesë-1, të Programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze)

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespondencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lartë, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs. Kandidatët të cilët aplikojnë në bazë të kuotës së veçantë, dorëzojnë dokumentet të cilat dëshmojnë kategorinë përkatëse.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes së listës përfundimtare), gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studentit regjistrohet)
- Tre fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
- Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - 100 denarë në xhiro-llogarinë 2401901047494695 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit të studentëve në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT)
 - 1200 denarë, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.
 - 750 denarë, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
 - Pagesën e mjeteve për semestrin e parë: në emër të Komisioneve për vërtetimin e diturisë dhe dijës.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- ❖ Në emri i marrësit (назив на примачот) - Universiteti Shtetëror i Tetovës,
- ❖ Në „banka e marrësit“ (банка на примач) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
- ❖ Në „llogaria“ (сметка) – 10000000063095,
- ❖ Në „shuma“ (износ) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
- ❖ Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (сметка на буџетски корисник – единка корисник) – 1600160054 788 10;
- ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave“ (приходна шифра и програма) – 723019 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;
- ❖ Në „thirrja në numrin“ (повикување на број – задолжување) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:
 - 723019 – 01: Fakulteti Ekonomik,
 - 723019 – 02: Fakulteti Juridik,
 - 723019 – 03: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,
 - 723019 – 04: Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë,
 - 723019 – 05: Fakulteti Filologjik,
 - 723019 – 06: Fakulteti Filozofik, Fakulteti pedagogjik
 - 723019 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë
 - 723019 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,
 - 723019 – 10: Fakulteti i Arteve,
 - 723019 – 11: Fakulteti i Administrimit të Biznesit.
 - 723019 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,
 - ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (kontrollimi i njohurive dhe aftësive, semestri etj)

Konkursi është shpallur në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>

Lista 1. Programet studimore në të cilat përveç zgjedhjes së lëndëve interne adekuate të dhëna në listën nr. 2, për shkak të specifikave të studimit kryhet kontrollimi i talentit dhe njohurive

Programet studimore në të cilat regjistrimi bëhet me provim pranues:

- Mjekësi e përgjithshme
- Stomatologji
- Farmacji
- Art figurativ
- Art muzikor
- Art dramatik
- Kulturë fizike: Aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi, Sport
- Informatika në gjuhën angleze
- Studime politike në gjuhën angleze
- Kriminalistikë
- Mësim klasor
- Drejtim parashkollor
- Arkitekturë

1. Kontrollimi i njohurive për të gjithë kandidatët:

1.1 Fakulteti i Arteve

- Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit figurativ do të mbahet në:

- Vizatim –portret i modelit të gjallë

- Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit muzikor do të mbahet në:

- Solfezh b) Piano obligat c) Harmoni

- Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit dramatik do të mbahet në:

- Ndjenjë e ritmit dhe dëgjimit,

B. Interpretimi i një monologu dramatik dhe i një kënge nga zgjedhja e kandidatit dhe një nga

zgjedhja e Komisionit,

- Improvizimi i temës së dhënë;

- Drejtimi Regjia e filmit dhe TV:

- Ese (punim me shkrim) në temën e dhënë (analiza e një filmi artistik) dhe bisedë me kandidatët;

-Drejtimi Montazh:

- Kontrollimi i talentit muzikor

- Provimi me shkrim- analizë e montazhit të filmit të treguar në një film artistik

-Drejtimi Kamerë:

A. Prezantimi i koleksionit personal të fotografive (10 fotografi bardh e zi, të përpunuara në laboratorin fotografik në konvencionin jo digjital me teknikë fotografike dhe format më të vogël 18 x 24 cm)

B. Informimi, motivimi si dhe përcaktimi i njohurive, dhe shkathtësive të kandidatëve për studime në artin dramatik do të përcaktohet përmes bisedës me kandidatët.

Provimet në të gjitha programet, respektivisht drejtimit e Fakultetit të Arteve do të mbahen në hapësirat përkatëse të programeve më: 26 shtator 2018 (e mërkurë), ora 10.00. (për informata më të hollësishme vizitoni faqen zyrtare të Universitetit)

1.2 Fakulteti i Kulturës Fizike - Provimi pranues në Programin studimor Kulturë fizike, Aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi, Sport do të mbahet nga:

- Not
- Hendboll, basketboll, volejboll, gjimnastika sportive
- Atletikë

Provimi pranues do të mbahet më: 26 shtator 2018 (e mërkurë) ora 09⁰⁰ në hapësirat e Fakultetit të Kulturës fizike. Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive dhe dokument identifikimi.

1.3 Intervista në programet studimore ku mësimi do të mbahet në gjuhën angleze:

Intervista për njohuritë dhe aftësitë në gjuhën angleze para komisionit përkatës do të mbahet më: 26 shtator 2018 (e mërkurë) ora 10⁰⁰, në hapësirat e Universitetit afër Rektoratit.

1.4 Kriminalistikë:

Provimi pranues do të mbahet më: 26 shtator 2018 (e mërkurë), në hapësirat e Fakultetit Juridik në:

- Testim psikologjik në inteligjencë joverbale: ora 10⁰⁰
- Testimin e lëvizjeve motorike: ora 12³⁰: kandidatët duhet të kenë përgatitje sportive

1.5 Fakulteti pedagogjik:mësim klasor dhe drejtimi parashkollor

Provimi do të mbahet më 26 shtator 2018, në këto fusha:

- Testim i aftësive intelektuale, test i inteligjencës jo verbale dhe Intervistë e strukturuar për aftësitë e komunikimit ora 09³⁰
- Testimi i lëvizjeve motorike: ora 13⁰⁰: kandidatët duhet të kenë përgatitje sportive

1.6 Fakulteti i Shkencave të Zbatuara - provimi pranues në Arkitekturë do të mbahet nga:

- A. Vizatim – kreacion i lirë i objekteve
- Provimi pranues do të mbahet më: 26 shtator 2018 (e mërkurë) ora 10⁰⁰ në hapësirat e në hapësirat e Arkitekturës.

2. Programet studimore, lloji dhe përmbajtja e testimit/seleksionimit (përmes kontrollit të njohurive dhe aftësive) për kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm dhe nuk kanë dhënë maturë shtetërore (2007/08), shtetas të RM-së me shkollim jashtë shtetit, kandidatë me lëndë interne dhe eksterne jo të përshtatshme:

2.1 Provimi pranues në programet studimore të Mjekësi të përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci:

- Biologji (njohuri të fituara nga arsimit i mesëm)
- Kimi (njohuri të fituara nga arsimit i mesëm)

Kandidatët të cilët nga lëndët A dhe B, kanë dhënë së paku njërin në lëndë eksterne ose interne, provimit pranues do t'i nënshtrohen vetëm në njërin nga lëndët. Kandidatët të cilët lëndët e përmendura i kanë në pjesën interne, komisioni qendror do të sjell vendim për pjesëmarrje në provim pranues.

Provimi pranues do të mbahet më: 26 shtator 2018 (e mërkurë) ora 11⁰⁰, në hapësirat e Universitetit te objekti i ri (rektorati). Kandidatët duhet të kenë me vete dokument identifikimi.

FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



www.izleziza.mk

- Ndhimja totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.
- Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.
- 15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).
- 8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.
- 15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.
- 18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

www.izleziza.mk

DASHI 21. mars - 20. prill
Këshillohet që këtë të diel ta kaloni me familjen, sidomos nëse ka disa çështje të cilat duhen riparë. Mundohuni që të jeni gati për tu përballur me disa sfida profesionale të cilat do të vënë në provë durimin tuaj. Takimet janë mjaft të favorizuara.

DEMI 21. prill - 21. maj
Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të arsyetoni më mirë lidhur me disa strategji që keni ndjekur në të kaluarën dhe që tani duhet të modifikohen. Këshillohet që të mos tregoheni kokëfortë, por të jeni më shumë pjesëmarrës, pasi horoskopi i kësaj dite hap një periudhë të rëndësishme, sa i takon një projekti të ri.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Duhet të ndiheni të lirë që të ndiqni instinktin tuaj, sidomos në ato çështje që kanë të bëjnë me zemrën. Do të keni një pavendosmëri e cila ju bën nervoz, por mos shkarkoni çdo trysni në punë, ose në të kundërt rrezikoni që të bëni ndonjë gabim.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Mos u ikni ndryshimeve, pasi bëhet fjalë për një periudhë të rëndësishme, për të përcaktuar qartë prioritetet tuaja profesionale. Disa vendime që duhet të merrni ju nervozojnë, por mos u dekurajoni! Intuita e mirë do ju vijë në ndihmë, ndërsa orët e mbrëmjes do ju shohin më romantikë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Hapet një fazë mjaft ngacmuese nga pikëpamja sentimentale, sidomos nëse ndiheni gati për të nisur një aventurë të re. Këshillohet që të refuzoni të gjitha ato oferta që nuk ju duken të përshtatshme me pritshmëritë tuaja.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Po afron një ditë e cila ju fton që të tregoheni tolerant dhe të durueshëm. Do të dini të jeni krenarë dhe kokëfortë dhe është pikërisht kjo arsyeja që shpesh ju konfliktin me bashkëpunëtorët. Në dashuri duhet të bëni kujdes!

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Kjo është një periudhë shumë e mirë për të zgjeruar rrjetin miqësor dhe për të bërë njohje të reja. Megjithatë nuk duhet të lini pas dore disa aspekte të jetës tuaj sentimentale, të cilat mund të minojnë stabilitetin e një raporti të lindur prej pak kohësh.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Pas një jave të ngjeshur me punë, kjo fundjavë do ju lejojë që të pushoni dhe të mendoni më shumë për veten tuaj, çështjet e ndjenjave dhe familjen. Në dashuri do të keni momente tensioni me partnerin/en, ndaj bëni kujdes me fjalët.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Mundohuni që të mos ulni kokën para kohe, sidomos nëse në dashuri po përballeni me disa keqkuptime me partnerin/en. Do të jeni më të komunikueshëm dhe të besueshëm, dhe kjo aftësi do të sheshojë çdo debat të ndezur.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Kjo e diel do ju gjejë të angazhuar në gjetjen e zgjidhjeve për disa probleme profesionale, të cilat duhet të zgjidhen brenda afatit. Mjaft të favorshme janë çështjet e biznesit.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Mundohuni që të mos i çoni dëm energjitë tuaja, sidomos nëse ka disa mundësi profesionale të cilat duhen kapur fluturimthi. Dashuria parashikohet me zhvillime të rëndësishme, por duhet të jeni gati për të bërë një ballafaqim.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Kjo fundjavë ju këshillon që të mos jeni ziliqarë ndaj suksesit të një pjesëtari të familjes ose partnerit/es. Jeni në një fazë të rëndësishme transformimi, ndaj duhet të dini të menaxhoni më mirë emocionet, sidomos në vendin e punës.

Mensur Mamuti	MOTOÇIKLISTI JAPONËZ, JUKI (VOZITËS I MARKËS NË FOTO)	BANOR I NJË VENDI TURISTIK SHQIPTAR	FILLUAR (MB.)	DRITËRO AGOLLI	MAHIA E ÇATISE	NE KETE DATE				
PRODHUESI JAPONËZ I VETURAVE, ROBOTËVE (NË FOTO)										
REGJISORI SHQIPTAR, CULIQI										
BUKUROSHË				IMPULSI						
MARKË AUTOMOBILASH E KOMPANISË NË FOTO										
NDARËSI I DHOMAVE					NJËRI NGA THEMELUESIT E KOMPANISË NË FOTO, HONDA					
NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE			DRAGO SILIQI							
NJËRI NGA THEMELUESIT E KOMPANISË NË FOTO, FUXHISAVA			GËZHOJË FISHEKU							
TRAJNERI BOSHNAK, IVICA (SHQ.)										
KOHA	BAR, MEDIKAMENT					MUNDJE JAPONEZE	S	FUTBOLLISTI YNË, CANA	L	IS KRYETARI I SHBA-VE, RIÇARD
	NJËRI QË FLET SHUMË					ZBULLUESI I GALVANOSKOPIT, LUIXHI		PUNA E DREJTUESIT TË FILMIT		
LLAMBDA		MERR MASA SIGURIE								
		REZIDENCA E KOMPANISË (SHIH FOTON)								
AMERICIUMI			FILM ME DASTIN HOFMAN, ... KUNDER KRAMERIT							
			PROFESION, MËSHTERI							
QË KA TË BËJË ME FIZIOLOGJINË										
EMRI I VJETËR VIETNAMIT						VOLTI		E PANJOHURA NË MATEMATIKË		
THIRRJE NGA MINARJA						SHKRONJË ARABE		SHOK, JARAN		
E				THIKË E MPREHUR NGA TË DYJA ANËT					OKSIGJENI	
				NOTË MUZIKORE					AMERICIUMI	
PRIJËSI I KOZAKEVE									PARAFJALË GJERMANE	
									ITALIA	
NJOFTIMI, JALMERIMI (HUAJ)										



ZGJIDHJET: HONDA, ARIAN, MIS, I AKURA, MURI, OM, DS, TAKEO, OSIMI, ILAÇ, S, L, LL, E SIGURON, AM, KRAMERI, FIZIOLOGJIK, ANAM, V, IKS, EZAN, KAMA, O, ATAMANI, AN, NOTIFIKIMI.

Shumë i lehtë Sudoku mesatar

7					6		9								2				
					3						1	4	8			2	7		
	5	3	7	9			6				6	7			8	1			
4	8				1	5					7	5			9			2	8
		6				1								3	5				
		2	8				4	7				9			2				6
	2			7	4	8	3					8	2					6	5
			6									7	6	2				4	3
	3		9					5								6			

Shumë i lehtë: 748526391, 269413758, 153798264, 487361529, 596247183, 312859647, 925174836, 874635912, 631982475. Mesatar: 835712946, 914863275, 267459813, 751694328, 628375194, 493128567, 382947651, 576281439, 149536782.

72 milionë njerëz nuk dëgjojnë, por...

Gjuha e shenjave është jeta e 72 milionë personave që nuk dëgjojnë në mbarë botën. Sipas statistikave, 80% e tyre jetojnë në vendet në zhvillim. OKB po përpilqet të sensibilizojë kombet për garantimin e të drejtave për personat që nuk dëgjojnë. Qëllimi është lehtësimi i procedurave për mësimin e kësaj gjuhe universale dhe të punohet më tepër për edukimin më cilësor. Organizmat ndërkombëtarë nënvizojnë rëndësinë e gjuhës së shenjave, e cila kalon të gjitha barrierat kulturore dhe ndryshimet gjuhësore të vendeve të ndryshme. Por një tjetër



sfidë është shtrirja e kësaj gjuhe dhe përdorimi i saj edhe nga personat që nuk kanë problem me dëgjimin apo të folurin, për të rrëzuar hendekun mes dy grupeve. Shembull janë disa fshatra, në Izrael, në Bali, në Ghana dhe Meksikë, ku ekzistojnë disa ko-

munitete që si pasojë e gjenetikës, numri i shurdh memecëve është në nivele shumë të larta. Mirëpo në këto komunitet diferenca nuk ndjehet, pasi të gjithë flasin gjuhën e shenjave dhe të kesh problem me dëgjimin nuk përbën asnjë pengesë.

Edhe bima kërkon "ndihmë" kur kërcënohet!

Bota bimore surprizon ende. Vjen rikonfirmimi i komunikimit mes tyre nga një studim i përbashkët amerikano-japonez i publikuar në revistën më prestigjioze shkencore Science. Kështu, së fundmi, është vërtetuar se bimët janë në gjendje të lëshojnë sinjale alarmi kur janë të ekspozuara ndaj një rreziku. Behët fjalë për sinjale kimike që lëvizin përgjatë gjetheve dhe kërcellit. Kërkuesit gjatë eksperimentit, kanë arritur të fotografojnë këtë sinjal 'SOS', pasi kanë injektuar substance fluoeshente tek bimët. Është marrë në shqyrtim një Arabidopsis Thaliana, dhe teksa një krimb ishte gati të kafshonte një gjethe të saj, bima ka nisur të lëshojë një sinjal që nisi të shpërndahej me shpejtësi 1 mm në sekondë derisa mbërriti në të gjitha gjethet dhe kërcell. Sipas studiuesve, kjo gjë konfirmon se behët fjalë për një sistem efikas komunikimi, i padukshëm për sytë tanë, dhe mjaft i ngjashëm me sistemin nervor të kafshëve. Mbeten ende të paqartë për autorët e eksperimentit, mekanizmat molekularë që shërbejnë si rregullatorë të transmetimit të sinjalit të alarmit në distancë dhe si lindin ato.

"Shpëtojeni" Supermanin



Pasi shpëtoi botën, duket se Superman ka nevojë që bota ta shpëtojë atë. Filmi shumë i dashur për të gjithë, po has probleme si në kastin e aktorëve, ashtu edhe me shikueshmërinë. Henry Cavill, i cili ka luajtur rolin e Superman në filmat "Njeriu i Çelikut", "Batman V Superman" dhe "Lidhja e Drejtësisë" nuk do të jetë më në rolin e heroit.

Edhe aktori Ben Affleck nuk pritet të përsërisë rolin e tij të Batman në filma të ardhshëm, pasi po trajtohet klinikisht

për varësinë që ka nga droga. Kompanitë producentë Warner Bros dhe DC kanë njoftuar se filmi Superman nuk do të prodhohet më.

Shkak mësohet se është bërë edhe fakti që prodhimet e fundit nuk janë pritur mirë nga kritikët, ndërkohë që kanë shënuar rënie drastike të shikueshmërisë.

Edhe pse organizuesit janë munduar të sjellin në filmat e fundit risi të reja, sërisht nuk ka patur sukses.

Habisin shkencëtarët: Peshkaqeni është vegjetarian?



Një grup shkencëtarësh të universitetit të Kalifornisë dhe Floridës zbuluan se një lloj peshkaqeni ushqehet vetëm me alga. Pra makthi i deteve dhe gjahtari i

tmerrshëm duket se në të vërtetë preferon më shumë vegjetacionin sesa mishin. Për të herë të parë është konfirmuar nga shkencëtarët se një varietet peshka-

qenësh, që konsumojnë edhe peshq të vegjël edhe kallamarë, preferojnë të ushqehen me alga, nga të cilat mesa duket marrin të gjitha vlerat që u duhen.

Bëhet fjalë për llojin Bonnedhead ose Sphyrna Tiburo, që gjendet në bregdetin e SHBA-ve dhe në Oqeanin Paqësor. Për shkencëtarët kjo ka qenë surprizë, pasi mendohej se peshkaqenët i konsumonin rrallë algat dhe gabimisht teksa ishin në ndjekje të gjahut. Pas studimeve të gjata mbi shumë peshkaqenë dhe mbetjet në stomakun e tyre, arritën në konkluzionin se aparati i tyre tretës ishte i përshtatshëm edhe për bimët. Nga studimet rezultoi se mbetjet në stomakun e tyre ishin 90% vegjetale dhe vetëm 10% nga kallamarë dhe karkaleca të vegjël.

1180 - Vdes Manuel I Komneni, Perandori i fundit i familjes Komneni.
1493 - Fillon ekspedita e Dytë e Kolumbos për në Botën e Re.

1625 - Holandezët sulmojnë San Huan, Porto Riko.

1664 - Holandezët i dorëzojnë Nju Amsterdamin anglezëve.

1688 - Franca i shpall luftë Gjermanisë.

1829 - Rusia dhe Perandoria Osmane nënshkruajnë Traktatin e Adrianopojës për Paqe.

1941 - Eksplozon bombë në rezidencën gjermane në Hotel Kontinental në Kiev.

1943 - Forcat sovjetike rimarrin Smolenskin.

1957 - Hapet stadiumi më i madh në Evropë Kamp Nou në Barcelonë.

1995 - Jahti i Emilio dhe Gloria Estefan godet dhe mbytet një xhetskiator.

Për botën, viti 2017 ka qenë viti më depresiv i dhjetëvjeçarit të fundit. Sipas statistikave globale rezulton se në këtë vit janë shënuar më shumë emocione negative se çdo vit tjetër, duke tejkaluar edhe vitin 2006 që mbante vendin e parë të podiumit deri më sot. Në bazë të sondazheve, në 2017 ka pasur përqendime me 1-2% në nivel trishtimi, dhimbjesh fizike, stresi dhe ankthi. Ndërsa i vetmi parametër që ka qëndruar i pandryshuar është ai i zemërimit, që ishte dhe është 20%. Duke kombinuar të gjitha këto të dhëna, është arritur në nivelin e indeksit negativ emocional, i cili ka rezultuar të jetë më i larti i regjistruar deri më sot. Sondazhi është kryer mbi 145 vende të planetit, dhe në krye të listës së vendeve më të palumtura rezultojnë Republikat e Afrikës Qendrore.



SHQIPTARI 175 VJEÇ

Një gazetar po interviston një plak me rekord jetëgjatësie 175 vjeç. Gazetari: Xhaxho, cili është sekretin i jetëgjatësisë suaj? Plaku: Në '97-ën kur Saliu... Gazetari: E dimë '97-ën. Sekretin e jetëgjatësisë duam! Plaku: Në '97 kur Saliu... Gazetari: Xhaxho e dimë, e dimë '97-ën, sekretin e jetëgjatësisë duam?! Plaku: Do më lesh ta mbaroj?! Në '97 kur Saliu ra nga pushteti, u bë një rrëmujë aq e madhe sa dikush më shtoi 100 vjet në dokumente! Ja ky është sekretin, se më plase!



Qeveritë duhet të kenë edhe barinj edhe kasapë. (Volteri)



KALENDARI HISTORIK 24 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS